



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë më, 30.01.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 28 janar 2019.
2. Seancë dëgjimore me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me çmimet e reja të vendosura nga Urdhri i Stomatologut.

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Klodiana Spahiu, Bardh Spahia, Arben Kamami, Edlira Bode, Flamur Golemi, Klotilda Bushka, Roland Xhelilaj, Adelina Rista, Nuri Belba, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Halim Kosova, Floida Kerpaçi, Ilir Pendavinji dhe Nora Malaj.

Mungojnë:

Almira Xhembulla dhe Vangjel Tavo.

Të ftuar:

Mira Rakacolli - Zëvendësministre e Shëndetësisë

Gjergj Koja, - Kryeinspektor i ISHSH, qarku Tiranë

Antoneta Njehrrëna - Drejtore e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Anis Thodhorjani - Drejtor i Klinikës Stomatologjike Universitare

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e komisionit meqë edhe kuorumin e kemi. Sot në rendin e ditës është parashikuar një dëgjese me ministren e Shëndetësisë për problemin e bërë tashmë publik të urdhrit për dyfishin e tarifave në shërbimin stomatologjik. Para se të vazhdoj më tutje, dua të informoj komisionin se me gjithë komunikimin intensiv që ne patëm në shkelje të Rregullores së Kuvendit, shkelje e qartë, me gjithë fleksibilitetin e madh për kohën dhe orën se kur mund të mblidheshim, ministrja e Shëndetësisë nuk pranoi të merrte pjesë. Them nuk pranoi, pasi objektivisht nuk u tha që ministrja nuk ndodhej në Shqipëri. Po të ndodhej jashtë, kjo do të ishte një rrethanë madhore që e bënte të pamundur prezencën, por përgjigjja ka qenë se kishte një axhendë që nuk mund ta shkelte. Këtë nuk e kuptoj dot nga pikëpamja morale, kurse nga pikëpamja shtetërore është e patolerueshme. Me gjithë axhendën që mund të ketë një ministër, Kuvendi është një vend ku ai duhet të gjejë vend në axhendën e tij. Rregullorja e Kuvendit në këtë pikë është shumë e qartë, nuk është rregullore as imja, as e kurrkujt që drejton komisionet parlamentare, pasi në nenin 102, pika 2 thuhet: “Komisionet kanë të drejtë të thërrasin në çdo kohë ministrat për të dhënë shpjegime dhe sqarime për probleme të fushave ku ata janë përgjegjës”.

Këtu nuk ka vend për asnjë lloj interpretimi, prandaj jam shumë i keqardhur. Qeveria ka pranuar të rishtojë një pozicion për të pasur një ministër për Marrëdhëniet me Parlamentin, meqenëse kjo marrëdhënie nuk mund të funksionojë më nga pikëpamja institucionale, sepse kështu duket. Unë mendova se vënia e një ministri do të ishte pak a shumë një nga ata bodecët që shpojnë, të paktën për të kuptuar rregullat, por edhe kjo gjë, siç duket, nuk funksionon. Prandaj edhe ky pozicion shtetëror është një pozicion pa kuptim kur nuk sigurohet prezenca e ministrave në parlament, i cili i votëbeson ata. Duhet sqaruar ministrat që nuk i votëbeson kryeministri, por parlamenti dhe për këtë arsye ka të drejtë t’i thërrasë në çdo kohë. Pra, parlamenti mund t’i thërrasë në çdo kohë, edhe për 24 orë në mënyrë urgjente për çështje të sensibilitetit të lartë publik.

Personalisht nuk e ndaj dot këtë rast. Më e keqja do të ishte arroganca, të jesh gdhë në punët e shtetit dhe të mos kuptosh, megjithatë kjo është një përgjegjësi politike dhe personale, të cilën unë si kryetar i Komisionit për Punën dhe Çështjet Sociale nuk do ta lë me kaq, por do t’i drejtohem edhe Kryetarit të Kuvendit, edhe opinionit publik. Duhet të ketë një respekt të kësaj Rregulloreje, e cila nuk është pronë e asnjërit prej nesh, Kuvendi, që nga momenti që ka thënë po,

ky është urdhër për zbatim nga kushdoqoftë drejtues komisioni, i opozitës, i maxhorancës, kushdo qoftë ai, i dakordësuar. Ai ka këtë rregull pune dhe këto detyrime reciproke që u vijnë anëtarëve të qeverisë për Kuvendin dhe Kuvendit për ta, sipas situatave që krijohen.

Gjithashtu, doja t'ju informoja se ne i ofruam Ministrisë së Shëndetësisë orare nga më të çuditshmet, pikërisht për të respektuar axhendën, megjithëse po jua them prapë edhe jo teorikisht këtë punë e kam bërë, por rregulli që mbi të gjitha gjërat prevalon parlamenti, ka qenë rregulli numër një. Gjithmonë është negociuar për një orë ose për një moment kur ka ekzistuar një mbledhje qeverie apo një marrëveshje e madhe me të huajt dhe komisionet i kanë rregulluar oraret brenda ditës. Kjo ka ndodhur tradicionalisht dhe është më se normale, por refuzimi i pjesëmarrjes është diçka e patolerueshme...

(Diskutime pa mikrofon)

Kishit ndonjë gjë për të shtuar?

(Diskutime pa mikrofon)

Sa i takon kësaj pike unë kisha vetëm këtë gjë, në qoftë se ju doni të ndërhyni, urdhëroni! Zonja Spahiu, e ka fjalën.

Klodiana Spahiu – Me lejen tuaj si kryetar i komisionit,

Ky komision ka një histori paraprake në lidhje me të gjitha ftesat që u janë bërë ministrave për të qenë prezentë në seancat dëgjimore. Së bashku vendosëm një kalendar 2 ditë më parë dhe mendoj se janë të ekzagjeruara komentet që ju bëni në lidhje me këtë procedurë. Keni plotësisht të drejtë që, sipas Rregullores, ministri duhet të jetë prezent, por duhet të kemi parasysh edhe tematikën që do të diskutohet. Nuk ka asgjë emergjente në çështjet që do të diskutojmë sot dhe mbi të gjitha ministria ka dhënë një përgjigje dhe i është drejtuar Gjykatës Administrative për të marrë një vendim...

Petrit Vasili – Kjo është një çështje që do të konsumohet gjatë debatit, në qoftë se do ta bëjmë...

Klodiana Spahiu – Të lutem...

Petrit Vasili - ... nuk ka lidhje fare me thelbin. Ne po themi për...

Klodiana Spahiu – Jo, pa u futur fare në thelbin e çështjes...

Petrit Vasili – Unë kam komentuar vetëm nenin 102, në qoftë se keni komente për këtë gjë, urdhëroni.

Klodiana Spahiu – Edhe unë po ju them në bazë të Rregullores ju keni të drejtë të kërkonit ministrin...

Petrit Vasili – Unë nuk po komentoj asgjë për përmbajtjen...

Klodiana Spahiu - ... por ju thashë që ky komision ka histori të mëparshme dhe me ministra të kaluar...

Petrit Vasili – Unë nuk merrem me histori të kaluara, por merret me precedentët e...

Klodiana Spahiu – Do të merremi ne. Koha për të cilën...

Petrit Vasili – E keni gabim në këtë drejtim, sepse unë jam duke folur për ditën e sotme, sepse ramë dakord që në këtë mbledhje...

Klodiana Spahiu – Ju lutem, zoti kryetar, ne ramë shumë dakord...

Petrit Vasili – Ne patëm dakordësi...

Klodiana Spahiu – ... të mos e fillojmë me debate, sepse është një çështje që...

Petrit Vasili – Nuk na e vë ti menunë se si do ta zgjedhim...

Klodiana Spahiu – Është e drejta juaj...

Petrit Vasili – Unë nuk bëra asnjë koment..

Klodiana Spahiu – Sa u takon komenteve që bëni për përgjegjshmërinë dhe në lidhje me gjërat e tjera...

Petrit Vasili – E po nuk kam se çfarë t’i them kur Rregullorja thotë...

Klodiana Spahiu - ... më duket të ekzagjeruara, sepse përfaqësia e zëvendësministrit...

Petrit Vasili – Janë për ministren, nuk janë për ty...

Klodiana Spahiu – Ne këtu bashkë po bëjmë mbledhjen...

Petrit Vasili – Po lëre, nuk kam nevojë, unë po i referohem Rregullores. Kur t’i referohem një dokumenti informal apo të prodhuar nga unë në mënyrë individuale, keni të drejtë të bëni çdo koment...

Klodiana Spahiu – Në rregull! Unë kam të drejtë të bëj komentin tim, zoti kryetar...

Petrit Vasili – Edhe një herë po jua them se komisionet kanë të drejtë të thërrasin në çdo kohë ministrat. Këtë gjë nuk e them unë, por Rregullorja dhe është miratuar me 137 vota.

Klodiana Spahiu - Në qoftë se ju dhe të gjithë anëtarët e komisionit mendoni se ky është një problem emergjent dhe që ministria, edhe pse ka qenë një problem që nuk kishte emergjencë kombëtare...

Petrit Vasili – Në Rregullore nuk thuhet as për probleme emergjente dhe as ndonjë problem tjetër. Dakordësia...

Klodiana Spahiu – Në rregull...

Petrit Vasili – Unë po zbatoj vendimin e përbashkët...

Klodiana Spahiu – Çdo ministër ka axhendën e tij. Ne së bashku në komision vendosëm ta thërrasim ministren, duke parë edhe axhendën. Ju insistuat që e donit ditën e mërkurë dhe ja ku u bë erdhëm të mërkurën...

Petrit Vasili – I thamë ministres se në çdo orë që do të vinte, madje edhe në orën 2, 3 apo kur të donte ajo, kur t'i krijohej mundësia...

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar, kemi një përfaqësi në rang zëvendësministri...

Petrit Vasili – Ju jeni e kënaqur që gjithë këta gra e burra të parlamentit nuk zënë dot vend në axhendën e ministres dhe nuk është në refenenë e të gjallëve...

Klodiana Spahiu – Axhendën e ministres nuk e bëjmë ne...

Petrit Vasili – Kush është mbi parlamentin dhe axhendën e ministres? Të na e thotë axhendën cila ka qenë dhe të gjejmë, se nuk po gjejmë vend...

Klodiana Spahiu – Ju lutem, zoti kryetar! Nuk është hera e parë që komisioni kërkon...

Petrit Vasili – Je vendosur keq në këtë çështje, nuk je vendosur në mënyrë korrekte...

Klodiana Spahiu – Jo, nuk jam vendosur keq. Unë do të kërkoja dashamirësisht që ju të tërhiqni komentet që bëni.

Petrit Vasili – Jo, nuk tërheq asnjë koment. Të tërheq komentet që kanë të bëjnë me këtë?

Klodiana Spahiu – Nuk është hera e parë që ne kërkojmë ministrin e Shëndetësisë dhe nuk është hera e parë që na është shtyrë...

Petrit Vasili – Nuk merrem me histori...

Klodiana Spahiu - ... ose kanë ardhur në rangun e zëvendësministrit, megjithatë meqë ju jeni të vendosur për këto komente...

Petrit Vasili – Meqë keni paragjykime...

Klodiana Spahiu – Nuk kam paragjykime...

Petrit Vasili – Po, ke paragjykime...

Klodiana Spahiu – Unë nisem nga historia 10-vjeçare, të paktën për aq sa kam qenë prezent...

Petrit Vasili – Unë jam drejtuesi i komisionit dhe meqë jam i opozitës, ti ke paragjykime. Para meje, në kohën kur ne nuk merrnim pjesë në Kuvend, ka drejtuar zonja Spiropali, e cila i ka shtyrë mbledhjet pikërisht për mospjesëmarrjen e ministrit. Ky është fakt që ka ndodhur po në këtë komision...

Klodiana Spahiu – Edhe këtë çështje e kemi diskutuar...

Petrit Vasili – Madje ka pasur keqardhje dhe pakënaqësi nga përfaqësuesit e komisionit pavarësisht krahut politik...

Klodiana Spahiu – Ka qenë mungesa e opozitës arsyeja që nuk e kemi bërë seancën dëgjimore ku është kërkuar prezenca e ministres...

Petrit Vasili – Nuk është kërkuar për shkakun se ministrja nuk ishte dhe ju e dini shumë mirë. Këto janë rekordet e komisionit e jo të miat.

Klodiana Spahiu – Ne duhet të biem dakord bashkë që ministria ka një axhendë të paracaktuar, ju këtë e dini më mirë se ne që jemi anëtarë të komisionit...

Petrit Vasili – Jo, nuk e dija, sot po e marr vesh, që për ju si deputete e parlamentit prej kaq kohësh prevalon axhenda e ministres dhe çdo gjë tjetër, ndërsa parlamenti është në fund. Parlamenti nuk është në fund, por është i pari...

Klodiana Spahiu – Po ju them se parlamenti është i pari, por koha e kërkesës sonë ishte e shkurtër. Ende nuk janë bërë 48 orë nga kërkesa jonë që ministrja të jetë e pranishme...

Petrit Vasili – Për 48 orë?! Në parlament janë futur dekrete për 3 orë, të mos u futemi këtyre debateve se janë të ngatërruara.

A ka ndonjë koment?

Po, zoti Bardhi.

Bardh Spahia – Zoti kryetar, po shfrytëzoj rastin t'i bashkohem shqetësimit tuaj për papërgjeshmërinë dhe neglizhencën e ministres së Shëndetësisë. Unë nuk arrij ta kuptoj, këtu përsëri i bashkohem shqetësimit të disa prej kolegëve, se çfarë mund të jetë më e rëndësishme për ministren dhe Ministrinë e Shëndetësisë në axhendën e saj sesa paraqitja sot përpara Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, aq më tepër për një çështje tejet delikate, për një shkelje të rëndë të ligjit, ku tashmë është vërtetuar që është i përfshirë direkt edhe institucioni që ajo drejton, madje-madje ndoshta edhe ajo vetë.

Është e rëndësishme jo vetëm për këtë komision, por edhe për qytetarët shqiptarë në përgjithësi që të sqaroni dhe të dëgjojmë sqarimet e ministres së Shëndetësisë për pozicionin e saj

në lidhje me këtë çështje, pasi u akuzua direkt nga Partia Demokratike, nga qytetarët, nga mediet për përfshirjen e ministres dhe të ministrisë në këtë skandal në lidhje me Urdhrin e Stomatologut.

Edhe një herë, unë i bashkohem shqetësimit tuaj dhe duhet ta ngremë me forcë kërkesën e kolegëve, të paktën të opozitës, për t'i bërë thirrje ministres për të treguar të paktën përgjegjshmërinë minimale për të ardhur këtu, për t'u paraqitur para komisionit parlamentar, siç e detyron Rregullorja, dhe të marrë përsipër përgjegjësitë e saj, duke sqaruar pozicionin e saj dhe të institucionit që ajo drejton.

Justifikimet për axhenda, që nuk përputhen me axhendën e Komisionit të Shëndetësisë, janë sa qesharake, aq edhe shenjë e papërgjegjshmërisë së saj, por edhe të eprorëve të saj, të Kryeministrit dhe të qeverisë.

Unë u bëj thirrje kolegëve të maxhorancës të tregojnë respekt për veten, respekt për parlamentin, respekt për qytetarët, të cilët kanë zgjedhur t'i përfaqësojnë dhe të mos mundohen t'i justifikojnë sjelljet e papërgjegjshme të ministres me axhenda më të rëndësishme sesa ky komision.

Është detyrim ligjor që ministrja të jetë sot këtu, aq më tepër kur kryetari i komisionit i ka dhënë të gjitha hapësirat për t'u përgatitur dhe për të ndryshuar çfarëdolloj axhende qoftë, e cila, sigurisht, nuk ka më rëndësi sesa paraqitja sot para këtij komisioni.

Edhe një herë, u lutem shumë kolegëve të maxhorancës të reflektojnë ndaj kësaj çështjeje Faleminderit!

Petrit Vasili – Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

Mendoj se jemi duke e hiperbolizuar situatën më shumë sesa duhet.

Të gjithë keni të drejtë që parlamenti është i pari dhe në axhendën e shërbimit publik, sigurisht, kërkesa që ushtron parlamenti duhet të respektohet, ama, nga ana tjetër, ashtu siç e parashikon Rregullorja, edhe ne duhet të kemi në konsideratë që nuk flasim për njerëz të cilët e kanë ditën 24 orë të lirë dhe janë në dispozicion të kujtdo sa herë kërkohet.

Rregullorja e parashikon qartë që në çdo kohë komisionet parlamentare, Kuvendi, kanë të drejtë të kërkojnë praninë e ministrave për të dhënë shpjegime në dëgjesa. Ama, ju rikujtoj se ne jemi mbledhur vetëm dy ditë më parë dhe kemi bërë një kalendar, ku kemi vendosur edhe datat.

Jam vënë në dijeni nga sekretaria e këtij komisioni se në këtë datë është argumentuar që vetë zonja ministre ka një axhendë të paracaktuar. Jo vetëm kaq, por, siç e dini të gjithë, sot është edhe ditë mbledhjeje qeverie.

Ne nuk mund të themi që i dhamë ministres hapësirë në çfarëdo ore të dëshirojë, sepse edhe kjo nuk shkon në përputhje me Rregulloren e Kuvendit...

Petrit Vasili – Ku është shkruar kjo në Rregullore?

Klotilda Bushka – Unë nuk ju ndërpreva kur folët.

Petrit Vasili – Ku në Rregullore në Rregullore kjo? Citoje.

Klotilda Bushka – Ndaj, për respekt ndaj Rregullores së Kuvendit...

Petrit Vasili – Jo, jo, mos na cito gjëra që nuk ekzistojnë!

Klotilda Bushka – ...mos më ndërprisni!

Petrit Vasili – Jo, jo, fiktivitete...

Klotilda Bushka – Për procedurë, ju nuk mund të më ndërprisni mua.

Petrit Vasili – Zonjë, ju jeni anëtare e re në këtë komision...

Klotilda Bushka – Jo, jo, unë nuk jam e re në parlament...

Petrit Vasili – Je e re që ç'ke me atë punë!

Klotilda Bushka – Kam një vit e gjysmë që jam në një komision tjetër.

Petrit Vasili – Keni një dispozitë së cilës i referoheni?

Klotilda Bushka – A mund të mos më ndërprisni?

Petrit Vasili – Do t'ju ndërpres që ç'ke me atë punë!

Klotilda Bushka – Dëgjoni, kjo është një çështje shumë e saktë dhe e parashikuar nga Rregullorja!

Petrit Vasili – Jo, nuk është gjëkund!

Klotilda Bushka – Unë kam të drejtën e fjalës dhe nuk mund të më ndërprisni!

Petrit Vasili – Citoni pikën së cilës i referoheni!

Klotilda Bushka – Ta mbaroj unë fjalën...

Petrit Vasili – Lërimi këto formalizma tani!

Klotilda Bushka – A më kërkuat t'jua citoj? Si ta citoj kur m'a ndërprisni fjalën?!

Petrit Vasili – Nuk jua ndërpres fjalën. Flisni çfarë të doni!

Klotilda Bushka – Po më hyni në fjalim!

Petrit Vasili – Lërimi tani, mos u merrni me këtë fiktivitet!

Klotilda Bushka – A ta mbaroj unë fjalën?

Petrit Vasili – Futu në thelbin e gjësë.

Klotilda Bushka – Ose do të jeni të rregullt në çdo gjë që parashikon Rregullorja, ose jo siç doni ju ta lexoni!

Petrit Vasili – Më thuaj një nen të Rregullores.

Klotilda Bushka – Atëherë, po ju them se këtë axhendë e kemi vendosur dy ditë përpara.

Petrit Vasili – Me dakordësi të plotë.

Klotilda Bushka – Me dakordësi të plotë tonën, pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por kjo nuk do të thotë që vendosëm...

Petrit Vasili – Si tonën? Tonën e kujt?!

Klotilda Bushka – Sot ka mbledhje qeverie dhe ministrja ka një axhendë të paracaktuar.

Petrit Vasili – Të kujt?

Klotilda Bushka – Për sa kohë sot është zëvendësministrja, drejtorët përkatës....

Petrit Vasili – Lëre, mos na i shpjego se kush është prezent, e dimë vetë ne atë, e shohim vetë!

Klotilda Bushka – Ata janë të deleguar nga ministrja për të dhënë sqarime në lidhje me çështjen që, po, janë dakord me këtë debat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Faleminderit!

Klotilda Bushka – Unë mendoj se po e ekzagjerojmë me këto komente thjesht për të krijuar një rrëmujë, e cila....

Petrit Vasili – Është në gjykimin e gjithsecilit...

Klotilda Bushka – ...nuk ka sens.

Petrit Vasili – Është në gjykimin e gjithsecilit si e vlerëson ligjin.

Klotilda Bushka – Në qoftë se ju do të doni me patjetër të keni ministren, nuk duhet ta vendosni datën dy ditë para, por duhet t'i kërkojmë komisionit...

Petrit Vasili – E vendosi komisioni.

Klotilda Bushka – Po, e lamë edhe me fleksibilitet, me sa mbaj mend, madje e keni në procesverbalin e mbledhjes.

Petrit Vasili – Për orarin e ministres.

Klotilda Bushka – Lamë fleksibilitet dhe kemi qenë këtu edhe kur këshilltarët e komisionit na kanë këshilluar që duhet të komunikojmë për gjithçka, sepse për dy ditë është e pamundur që ne të arrijmë ato që duam.

Çështja është e rëndësishme, e vendosëm së bashku dhe, sigurisht, edhe prezenca e zëvendësministres për mua tregon përgjegjshmëri, e cila sot këtu ka ardhur me njerëz të përgatitur. Nuk është e thënë që të vijë vetë ministria.

Praktika parlamentare jo e këtij viti, por e të gjithë kësaj kohe ka treguar se në mungesë...

Petrit Vasili – Ka qenë një praktikë e gabuar.

Klotilda Bushka – ...të ministrit, vjen zëvendësministri. Këtu nuk po vjen një specialist i thjeshtë i ministrisë, por po vjen zëvendësministri.

Petrit Vasili – Ajo ka qenë një praktikë e gabuar, e cila është kontestuar edhe nga Kryetari i Kuvendit, i cili nuk është i opozitës...

Klotilda Bushka – Unë them të mos merremi me formën, por me përmbajtjen.

Petrit Vasili – ...dhe e ka ngritur këtë çështje edhe në Konferencën e Kryetarëve.

Klotilda Bushka – Në qoftë se ne nuk do të jemi të ezauruar në pyetjet tona...

Petrit Vasili – Mirë, mirë.

Klotilda Bushka – ...nga prania e zëvendësministres dhe e përfaqësuesve të ministrisë, e vendosim së bashku për të thirrur ministren në një ditë të përshtatshme.

Petrit Vasili – E qartë. Faleminderit! Vazhdojmë.

Klotilda Bushka – Prandaj po ju them që respekti për këtë parlament ekziston nga maxhoranca ndoshta më shumë se ju, se ne nuk e kemi bojkotuar ndonjëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, të mos e hiperbolizojmë çështjen!

Petrit Vasili – Historia fillon tani.

Klotilda Bushka – Le të merremi me thelbin.

Petrit Vasili – Nuk kanë bojkotuar tani, por më përpara. E ke historinë e shkurtër dhe nuk i mban mend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbyllim tani këtë debat, i cili ka këtë kuptim, që, për sa i përket çështjes së mospjesëmarrjes së ministrave, ky ka qenë një shqetësim, për dijeninë e të gjithë atyre që nuk dinë gjë fare për këtë punë, i ngritur në Konferencën e Kryetarëve nga Kryetari i Kuvendit, zoti Gramoz

Ruçi, me shumë të drejtë dhe e kam mbështetur plotësisht, pasi fenomeni ka qenë shumë kritik dhe mbi të ka lindur edhe ideja që marrëdhëniet me parlamentin duhen ngritur në nivel tjetër, madje qeveria arriti të ngrejë nivelin “ministër”.

Këtu nuk kam ndër mend të dëgjoj komente nga asnjë tjetër, sepse ky ka qenë një fenomen që i kundërvihet Rregullores, e cila nuk predispozon asnjë nga këto histori. Megjithatë, është në vlerësimin politik të kujtudo se çfarë raporti do të ndërtojë me parlamentin, çfarë përgjegjësisht ka lidhur me këtë çështje, çfarë përgjegjësisht ka me ndjeshmërinë publike, cilat janë ndjeshmëritë publike që presin, ato që nuk presin. Pra, secili ndahet në këtë pikë: në të përgjegjshëm dhe në të papërgjegjshëm. Por ka edhe një vlerësim, që e bën opinionin publik, përveç rregulloreve, ligjeve dhe rregullave të funksionimit.

Kështu që, duke qëndruar në këtë pikë, por duke e nënvizuar, pasi besoj se mungesa e seriozitetit i tejkaloi kufijtë dhe këtu çdo vendimmarrje ishte e dakordësuar, mund të mos ishte e dakordësuar, siç ka ndodhur, ndërkohë që ishte e dakordësuar dhe shumë mirë që u tregua një ndjeshmëri, pasi kur ka ndjeshmëri të madhe publike, ne të merremi me avokatinë e ministres, është një gjë që nuk na vë në raport të mirë me opinionin publik.

Unë nuk e bëra, por as kolegët e tjerë nuk e kanë bërë dhe shumë mirë.

Për sa i takon thelbit të çështjes, sipas grupit të punës, i cili gjithashtu u negociua disa herë, prezentë këtu kemi zonjën Mira Rakacolli, zëvendësministre, zotin Gjergj Koja, kryeinspektor i qarkut Tiranë, zonjën Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë e Drejtorisë së Programit, Standardizimit dhe Harmonizimit, si dhe Anis Thodhorjani, drejtor i Klinikës Stomatologjike Universitare.

Nuk e di, ju citova të gjithëve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, atëherë.

Roland Xhelilaj – Për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Po, urdhëroni.

Roland Xhelilaj – E ngrita dorën që në fillim, por ju nuk ma dhatë mundësinë.

Petrit Vasili – Nuk ju kam parë.

Roland Xhelilaj – Duket si ndërhyrje tani, pasi ju bëtë një lloj mbylljeje.

Petrit Vasili – Më falni, nuk ju kam parë!

Roland Xhelilaj – Nuk ka problem. Dua të theksoj diçka. Opinioni juaj, që duhet të jetë ministria, është plotësisht i drejtë, pasi ka të bëjë edhe me Rregulloren. E gjithë pjesa tjetër e analizës së opinionit konsiderohet individuale juaja dhe jo e komisionit ose, thënë ndryshe, kur ka një opinion ndryshe nga ju, nuk keni të drejtë t’i ndërhyri nënkryetares për çdo fjalë që thotë, sepse ato që ju nxirrni si konkluzione, për ne nuk janë të rregullta, reale dhe qytetare.

Bëhet kërkesa që duhet të jetë ministria, në përputhje me Rregulloren e funksionimit të parlamentit, jemi dakord. E gjithë pjesa tjetër e komenteve të konsiderohet si opinion personal juaji me qëllim politik.

Ne kemi qëndrimin tonë. Kërkojmë ministren, ndërkohë që, në mungesë të ministres, për arsye objektive, jemi dakord që të katër përfaqësuesit këtu e plotësojnë shumë mirë pozicionin për të cilin ne e bëjmë mbledhjen sot.

Petrit Vasili – Ndonjë gjë tjetër?

Roland Xhelilaj – Kaq kisha.

Petrit Vasili – Faleminderit!

Roland Xhelilaj – Madje do të kërkoja nga ju që të paktën në vazhdimësi të keni qytetarinë në këtë proces.

Petrit Vasili – Nuk pranoj asnjëlloj komenti të kësaj natyre, zoti deputet, për një arsye shumë të thjeshtë: unë shpreh opinionet e mia individuale, edhe ju po ashtu, si dhe secili shpreh opinionet e tij individuale.

Nuk thashë “në emër të komisionit”, ose nuk më keni ndjekur...

Roland Xhelilaj – Jo, gjatë gjithë kohës keni thënë: “si kryetar i komisionit”...

Petrit Vasili – ...ose keni qenë i ngarkuar.

Unë kur flas, nuk flas si kryetar i komisionit, por jap opinionet e mia individuale dhe kam një votë, që është e barabartë me gjithë të tjerët. Ama opinionet do t’i them të gjitha pa kufizime dhe pa u shqetësuar se çfarë mendon ndonjëri këtu në tavolinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Xhelilaj – Dakord, madje unë këtë merak kisha, që edhe opinioni publik ta dinte se ky është opinion i juaj personal, jo i komisionit.

Petrit Vasili – Edhe ky është opinion i juaj personal, si dhe i të gjithë të tjerëve është opinion personal.

Roland Xhelilaj – Patjetër që është personal.

Petrit Vasili – Edhe ju nuk flisni në emër të të dhjetëve përnjëherësh.

Roland Xhelilaj – Jo.

Petrit Vasili – Vetëm kur jua ngarkojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përpara se të fillojmë dëgjuesën, a ka pyetje nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërtohet nëpërmjet pyetjeve, ju e dini.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht me pyetje, sepse ata kanë ardhur që të marrin pyetjet tona dhe pastaj të shpjegojnë çështjen.

Klodiana Spahiu – Së pari, nga ju të nënvizohet tematika e seancës dëgjimore dhe pastaj...

Petrit Vasili – Tematika është përcaktuar në rendin e ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tematika e seancës dëgjimore është çështja që Urdhri i Stomatologut ka miratuar një urdhër për dyfishimin e tarifave në shërbimin stomatologjik. Madje edhe në faqen e tij zyrtare, në vendimet e Këshillit Kombëtar, ka disa çudira tejet të mëdha. Në njërin prej tyre thuhet: “Në datën 06.12 është miratimi i listës së çmimeve dysHEME për shërbimin dentar”, pastaj te një tjetër thuhet: “miratimi i listës së çmimeve dysHEME për shërbimin stomatologjik”. As nga ana formale nuk merret vesh që është i datës 14.12.2018, për të cilin ka pasur një ndjeshmëri tejet të lartë publike dhe denoncime publike, të cilat më pas u bënë medietike, nëpërmjet të cilave u njoh edhe opinioni.

Pas mënyrës si u njoh, ka pasur disa qëndrime publike, ku një qëndrim ka qenë nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili ka përvijuar edhe me marrjen e vendimit përkatës; ka pasur deklarata nga ministrja e Shëndetësisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë; është bërë publike edhe një padi nga Ministria e Shëndetësisë, siç citohet nga aktet, në datën 25.01.2019, që i bie rreth një muaj e gjysmë pasi është marrë vendimi në Urdhrin e Stomatologut.

Arsyeja është shumë e thjeshtë: ne jemi përpara një situate ku një institucion i caktuar, jashtë çdo lloj kompetence ligjore, merr një vendim të caktuar. Në këtë institucion, pra tek Urdhri i Stomatologut, Ministria e Shëndetësisë ka përfaqësuesit e saj. Jo rastësisht në vitin 2014, kemi qenë bashkë në këtë komision kemi ribërë të gjithë pjesën ligjore të urdhrave, duke i rishikuar nga e para, për të standardizuar edhe qëndrimin ligjor ndaj tyre. Parashikimi i përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë ishte pikërisht për të krijuar urën lidhëse për të pasur prezencë atje dhe

për të qenë në njëfarë mënyre edhe kujdestarë për zbatimin e legjislacionit. Ky Urdhër, në rastin në fjalë Urdhri i Stomatologut, sikurse edhe Urdhri i Mjekëve, i Infermierëve dhe i Farmacistëve, të gjithë, kanë një legjislacion, i cili është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Detyrimi për t'iu bindur atij legjislacioni është detyrim ligjor, pra jo fakultativ. Urdhri është një bashkim profesionistësh, siç dihet, i cili ka një mision të caktuar.

Shqetësimi ka qenë se është marrë një vendim nga një institucion, që nuk ka të bëjë fare me këtë vendim që ka marrë, në asnjë pikë dhe në asnjë moment të tij. Në rastin konkret, madje pa e tepruar ose pa e ekzagjeruar, në rast se problemi nuk do të ishte bërë publik, nuk do të kishte pasur asnjë reagim publik, rrezik ato tarifa edhe mund të kishin hyrë në fuqi, çka do të binte në kurrizin e qytetarëve pa pasur asnjë ndryshim në kualitetin e shërbimit. Kjo është fare evidente. Por çudia më e madhe është që Ministria e Shëndetësisë, e cila është prezente atje, vihet në lëvizje pasi vihet në lëvizje media shqiptare. Kjo është e patolerueshme, sepse, po të ishte ndryshe, dhe këtu nuk ka mundësi objektive për të kundërshtuar... Njeriu mund të kundërshtojë, mund të gjejë mundësi që të thotë edhe një gjë fare pa kuptim, por fakti se ky është miratuar në datën 14 dhe paditet nga Ministria e Shëndetësisë në datën 25, një muaj e gjysmë më pas, së pari dhe, së dyti, Ministria e Shëndetësisë, të paktën në raport me opinionin publik, më e pakta do të duhej të kishte bërë një kallëzim penal për shpërdorim detyrë të këtyre njerëzve, pasi këta njerëz, që marrin dhe miratojnë një gjë, që nuk është fare në tagrin e tyre, pra nuk ka lidhje fare, ky as më shumë, as më pak, është një mashtrim publik.

Sepse çdo akt që nxjerr cildo institucion, thotë: “bazuar në ligjin kaq, pika kaq, neni kaq”. Ku e bazuan këtë? Si e pa Ministria e Shëndetësisë që ishte prezente atje brenda? Si mund të toleronte të bëhej një mashtrim publik i këtyre niveleve?

Ky institucion, në raport me të drejtën për të vendosur tarifa, është aq larg nga kjo çështje nga ana ligjore, sa është çdo lloj enti dhe institucioni tjetër. Pse? Sepse ligji nuk i ka dhënë asnjë mundësi që të merret dhe të vendosë tarifa. Madje nuk mund të paditet, pasi ky nuk është palë me Ministrinë e Shëndetësisë. Ky është në kushtet e një mashtrimi publik dhe i një shpërdorimi të pastër të detyrës.

Firmën e kujt i kanë vënë poshtë? Tarifat e kujt? Vallë nuk e di njeri kush e ka të drejtën të vendosë tarifa, kush i propozon dhe kush i miraton në shtetin shqiptar? E për çfarë është Ministria e Shëndetësisë atëherë? Po pra, është një pjesë e ekzekutivit, pjesë e qeverisë, që është çoban i kësaj pjese, që kudo shikon, po, bën menjëherë pezullimin. Në qoftë se ka kokëfortësi, e

ndjek dhe i thotë prokurorisë: shkoni se keni një grup atje që kanë manipuluar opinionin publik dhe kanë nxjerrë disa gjëra që janë absolutisht jo vetëm mashtrim dhe të rreme, por nuk kanë ku të venë më. Kush ta hajë, ta hajë dhe të paguajë dyfishin e parave! Kjo është, se nuk ka ndodhur asgjë tjetër.

Kështu që lidhur me këtë çështje janë pyetjet: pse reagimi i Ministrisë së Shëndetësisë është kaq i vonë? Pse Ministria e Shëndetësisë nuk mori qëndrim të menjëhershëm që të nesërmen e ditës...? Pra, data 14 dhjetor është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo nuk është datë e imja, por e Urdhrit përkatës, ja tek e keni me firmën e këtij presidentit të Urdhrit të Stomatologut që në datën 14.12.2018.

Për korrektesë, se nuk dua të kem komente, pasi nuk i kam qejf komentet që bëhen mbi fakte, kjo është padia e Ministrisë së Shëndetësisë, e cila mban datën 25.01.2019.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto papërputhshmëri na duhet të shpjegojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, këto ishin pyetjet e mia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fillimisht do ta marrë fjalën zëvendëskryetarja dhe pastaj ju.

Klodiana Spahiu – Atëherë, përpara se të bëj pyetjen, dua të bëj një sqarim shumë të shkurtër që ju e nisët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lidhur me misionin e Urdhrit të Stomatologut, këtë të fundit e kemi miratuar në këtë komision dhe është bërë një punë shumë e madhe nga komisioni, nga të gjithë anëtarët e asaj kohe. Në fakt, miratimi i të gjithë urdhrave që kemi miratuar ka qenë një hap shumë pozitiv.

Misioni nuk e ka tagrin që të përcaktojë çmimin. Ju në pyetjen tuaj dhe unë në pyetjen time, që do të vazhdoj, do t'i kërkoja ministrisë, me përfaqësinë që ka pasur në Këshillin Kombëtar, se ju nuk keni përfaqësi në asamble, por vetëm në Këshillin Kombëtar, që, me sa jam në dijeni, keni qenë edhe përfaqësuese e ministrisë në Këshillin Kombëtar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani është momenti i duhur që ju të deklaroni çfarë keni thënë, madje të deklaroni edhe votën tuaj atje dhe qëndrimin që ka mbajtur ministria, në mënyrë që të përballemi me të vërtetën

dhe ta marrim vesh edhe ne, edhe mediet dhe kushdo tjetër që ministria ka qenë gjithnjë kundër atij propozimi.

Pastaj, propozimi i miratuar me shumicë votash në Këshillin Kombëtar është votuar në asamblenë kombëtare, ku ministria nuk ka përfaqësues.

Nuk mund ta marrë vesh dot ministria se çfarë vendos Asambleja e Stomatologëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Është në web.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Një minutë, ju lutem!

Ato e kanë bërë fakt të kryer dhe...

Petrit Vasili – Referimi në web është për të gjitha dokumentet zyrtare të shtetit shqiptar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Shumë mirë.

Ajo që duhet të pranojmë të gjithë është se tashmë kjo çështje, me një kërkesëpadie nga ministria, ndodhet në Gjykatën Administrative.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam të drejtën e fjalës.

Petrit Vasili – Duhet ta shpjegojnë ata.

Klodiana Spahiu – Jo, jo, ashtu siç folët ju, zoti kryetar, kam edhe unë të drejtën të flas!

Petrit Vasili – Të pyesim ata.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Jo në emrin e ministrisë, por në emrin tim dhe në emër të informacionit që unë kam marrë këto dy ditë lidhur me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me ato që kanë problemin, edhe me ministrinë. Kështu që, ju lutem, duhet të jemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam pyetjen time.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, doktor, se do të bëj pyetjen time!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi një aktpadi nga Ministria e Shëndetësisë dhe presim një vendim të Gjykatës Administrative që, normalisht, këtë seancë dëgjimore sot nuk duhet ta bënim përderisa kjo çështje është në Gjykatën Administrative.

Megjithatë, ju e vendosët, ne ramë dakord të gjithë, meqenëse është një çështje me sensibilitet. Por meqenëse e akuzojmë ministrinë se është dakord për këtë gjë...

Petrit Vasili – Mund të kishit thënë: nuk e bëjmë.

Edhe thamë e bëjmë, ndërsa tani themi: pse po e bëjmë?! Vetë ramë dakord që ta bëjmë mbledhjen.

Klodiana Spahiu – Ramë dakord me konsensus, meqenëse çështja ka sensitivitet.

Petrit Vasili – Në qoftë se ju thonë juve se është gabim...

Klodiana Spahiu – Që ju të akuzoni ministrinë se është palë, kjo është një gjë...

Petrit Vasili – Unë nuk po e akuzoj, unë po e pyes: pse priti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëre, se ma shpjegojnë ata.

Klodiana Spahiu – Në rregull, unë kam pyetjen time.

Petrit Vasili – Unë nuk ju pyeta juve, por ata.

Klodiana Spahiu – Unë kam pyetjen time.

Petrit Vasili – Të marr përgjigjen e pyetjes...

Klodiana Spahiu – Pyetjen e kam konkrete: cili ka qenë qëndrimi i përfaqësisë së ministrisë në Këshillin Kombëtar të Stomatologëve dhe çfarë veprimesh keni ndërmarrë ju nga ana juridike pasi keni parë të shpallur vendimin e asamblesë kombëtare?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Njehrrëna – Përshëndetje të gjithëve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Më falni, zonja Njehrrëna, t'ju citoj diçka që ta keni gjatë përgjigjes, për referim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Statuti i Urdhrit të Stomatologut, i miratuar nga ansambleja dhe të gjitha institucionet...

Antoneta Njehrrëna – Vetëm ansambleja.

Petrit Vasili – Pika e parë, te bashkëpunimi, thotë: “Urdhri i Stomatologut, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë e institucionet në varësi të saj dhe me ministritë, institucionet qendrore dhe organizma të tjerë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi, publikë ose jopublikë.”

Antoneta Njehrrrena – Ky citim është në nenin 7 të ligjit “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, një nen, i cili përcakton bashkëpunimin e urdhrit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet varëse të saj. Urdhri i Stomatologut funksionon me organet e tij drejtuese, që janë: Këshilli Kombëtar, këshillat rajonale dhe Asambleja Kombëtare. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë i Urdhrit. Në Këshillin Kombëtar ka 25 anëtarë, që janë kryesisht përfaqësues të anëtarësisë së Urdhrit, janë profesionistë stomatologë, ka edhe 1 përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, që në rastin konkret, jam unë. Në atë mbledhje të Këshillit Kombëtar është vendosur që të kalojë dhe nuk ka pasur një njoftim paraprak për këtë propozim, që do të bënte Urdhri. Është vendosur aty dhe, aty për aty është bërë kundërshtimi im jo vetëm me votë, por edhe me argumente ligjore që vendosja e tarifave nuk është kompetencë e Urdhrit të Stomatologut.

Petrit Vasili – Me fal!

Të të bëj një pyetje për të qenë korrektë? Kam bërë unë 2 pyetje dhe më pas ka qenë pyetja e zonjës Spahiu. M’u përgjigj mua njëherë dhe pastaj përgjigju në mënyrë kronologjike, se i more së prapthi pyetjet! Të jemi korrektë, të marrim përgjigjet përkatëse, t’i shterojmë bashkë dhe më pas jep përgjigjen e radhës. Pyetja ka qenë shumë e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë do më shpjegosh? Bëra 2 pyetje dhe marr përgjigje. Mbaron, e shteron dhe më pas, vazhdon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të marr përgjigjen, se ka një logjikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbarojë një herë me përgjigjet e pyetjeve të mia. Nesër do ta marr unë përgjigjen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos ndërhy, zonjë!

Problemi ka qenë shumë i thjeshtë. Po e përsëris, m'u përgjigj meqë e filluam bashkë dhe pastaj përgjigju të tjerëve. Nëse njëërës pyetje i përgjigjesh më gjatë apo më shkurt, kjo është në diskrecionin tënd dhe nuk ka asnjë problem. Siç të thashë, pyetja është shumë e thjeshtë: ky vendim është marrë në datën 14.

Antoneta Njehrrëna – Vendimi i datës 14 është vendimi i asamblesë. Ministria e Shëndetësisë nuk ka përfaqësues në asamble. Në datën 6 ky vendim do t'i kalonte asamblesë.

Petrit Vasili – Më fal!

Kjo nuk ka asnjë rëndësi. Mos bëjmë lojëra fjalësh! Në datën 14 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pyes atë. Nuk po ju pyes ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është fillestare në këtë punë ajo. Unë kam punuar me të unë, para se ta njihje ti. Çështja

...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të vazhdojmë?

Në fund të fundit, një gjë është e vërtetë. Është marrë në datën 6 në kryesi dhe më pas ka shkuar në asamble. Bukur. Ky vendim, siç e kam gjetur unë dhe siç e kanë gjetur mediet, ka qenë në web prej kohësh. Pyetja është shumë e thjeshtë:

E para, pse u prit kaq kohë për këtë çështje? Kaloj gjithë kjo kohë dhe në fund të fundit, ju e dini se në raport me urdhrat mbahet gjithmonë një komunikim i vazhdueshëm dhe njihen me faktet dhe sigurisht (sektori apo s'e di se kush është në Ministrinë e Shëndetësisë), një nga detyrat që ka pasur, ka qenë ndjekja e veprimtarisë së urdhrave. Kështu ka qenë të paktën në një ministri të organizuar, që ka pasur një sektor të madh, siç është sektori i stomatologjisë. Në rast se do të më thoni me shpjegim se nuk ka fare interes për stomatologjinë dhe është lënë në dorë të Zotit, kjo është histori tjetër.

Së dyti, pyetja e tjetër që kam bërë para se të shpjegohet qëndrimi që ka mbajtur Ministria e Shëndetësisë, që ka pak rëndësi, sepse e di e gjithë dynjaja që kjo ministri nuk ka votë shumice, por ka një votë për të shprehur opinionin e saj. Dihet se vota e saj nuk është përcaktuese, sepse raporti i numrit të saj me numrat e tjerë është i parëndësishëm, por prania e përfaqësueses së saj atje është sa për të mbajtur lidhjet.

Pyetja është: këta janë në kushte të qarta të një mashtrimi publik, sepse kanë marrë një vendim që nuk është në kompetencat e tyre. Kjo është sikur t'i mbushet mendja një OJQ-je, sepse kjo është një OJQ profesionistësh, atë status ka, të marrë vendime. Çfarë do të bëjë? Gjëja e parë është të akuzohet për mashtrim publik dhe për shkelje të ligjit. Këta nuk janë palë. Ju keni shkruar në Gjykatën Administrative sikur këta janë pala juaj, ndërkohë që këta nuk janë palë. Këta kanë bërë thjesht një mashtrim publik. Këta kanë marrë përsipër një atribut, që nuk e kanë të përcaktuar në ligj.

Pyetja ime është: Pse nuk u zgjodh kjo rrugë për t'i dhënë edhe një përgjigje opinionit që të dëgjonte qartë? Këta kanë marrë një vendim, duke u nisur nga interesa absolutisht jo të mira, sepse po të kishin interesa të mira do të shkonin në Ministrinë e Shëndetësisë dhe do të thoshin se u kishin lindur këto probleme dhe se ajo është ajo që ka të drejtën të çojë propozime në Ministrinë e Financave dhe të ketë një rrugë ekzekutive, burokratike, që njihet. Ata e kanë bërë në mënyrë të tillë. Ju keni zgjedhur të përballeni me ta. Ata nuk janë përballë jush, por janë kundër ligjit.

Që ta kuptojmë, vazhdojmë me këto dy qasje dhe më pas do të dëgjojmë edhe qëndrimin e Ministrisë së Shëndetësisë, por e ka përcaktuar ligji që ju nuk keni votë shumice. Edhe sikur gjithë ditën të bërtisni, ata kanë mbi 95% të votave. Problemi qëndron këtu: pse pritëm? Si na iku situata? Pse u vumë përpara faktit të kryer?

Ju e dini shumë mirë që edhe Autoriteti i Konkurrencës ka reaguar me vendim më përpara se Ministria e Shëndetësisë, që ka lidhje dhe ka përfaqësuesin e vet në Urdhër.

Më thuaj!

Antoneta Njehrrëna – Normalisht, për pjesën pse ministria ka reaguar kaq vonë, sigurisht Ministria ka pritur, bazuar në nenin 7 të ligjit për bashkëpunimin, që të vinte një njoftim zyrtar shkresor nga Urdhri. Kemi pritur që Ministria e Shëndetësisë, të vihej në dijeni me një shkresë zyrtare nga Urdhri për këtë vendim të asamblesë. Kjo nuk ka ndodhur.

Në momentin që është bërë publik vendi i asamblesë, kemi reaguar menjëherë dhe reagimi i ministrisë është bërë në Gjykatën Administrative për të konstatuar moskompetencën e Urdhrit për të nxjerrë një akt të tillë administrativ. Gjykata është ajo, që do ta ndjekë dhe do ta vlerësojë çështjen.

Petrit Vasili – Gjykata Administrative?

Antoneta Njehrrrena – Ne gjykojmë se duhet konstatuar fillimisht moskompetenca, përderisa ne nuk arritëm ta bindim Urdhrin që është në tejkalim të kompetencës dhe ai vazhdoi me vendimin e tij në asamble, i jemi drejtuar Gjykatës Administrative, pikërisht për të konstatuar moskompetencën e Urdhrit për të nxjerrë një akt të tillë administrativ.

Petrit Vasili – Ku dallohet juridikisht një mashtrues, që shkel ligjin nga ai që vepron brenda sferës së kompetencës? Kjo është një pyetje e thjeshtë, nuk është për nivelin tënd që je një juriste e vjetër, por je këtu për të përfaqësuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe unë mendoj se kot të kanë vënë në këtë siklet kaq të madh. Ky është një mashtrim i qartë publik. Kur një gjë është kundër ligjit, është kundër ligjit. Ai që shkel ligjin, nuk është palë. Po të më vijë mua ndonjë që të më thotë se është palë ai që shkel ligjin, është sikur të më vijë mua ndonjë dhe të më thotë sikur t'i teket një ministrie që s'ka lidhje, për të vënë tarifa për shërbimin stomatologjik. Po kaq larg është edhe Urdhri për këtë kompetencë, se nuk e ka gjëkundi të shkruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjitha kompetencat e urdhrat janë qartësisht të orientuara në një drejtim tërësisht tjetër. Jo vetëm aq, por me këtë mashtrim ata kanë goditur edhe thelbin e ekzistencës së urdhrave profesionale, të cilët janë për një qëllim krejtësisht tjetër dhe në bazë të tyre kanë Kodin e Etikës dhe Kodin Deontologjik. Urdhrat nuk kanë fare të bëjnë me çështjen e elementeve komerciale. Në momentin që elementet komerciale, siç është ky i tarifave, hyjnë në një urdhër, ai ka rënë dhe ka vdekur sepse ka humbur thelbin e tij. Ne nuk kemi bërë gjë. Ne i kemi parë urdhrat si një eksperiencë qindravjeçare, si një bashkim profesionistësh që në radhë të parë kanë çështjet e etikës mes profesionistëve dhe së dyti, kanë problemin e raportit të tyre me trajtimin e papërshtatshëm mjekësor etj. dhe formimin profesional. Këto janë e pikat kryesore të zbërthyer në ligj.

Çfarë janë këta? Këta janë mashtrues. Nuk kanë asnjë emër tjetër. Në momentin që ju i çoni në gjykatë, i bëni palë. Ata nuk janë palë, por janë mashtrues. Kaq. Kanë marrë përsipër të 2-fishojnë tarifat. Si do t'i 2-fishojnë tarifat ata? Do t'i 2-fishojnë tarifat, duke pasur të njëjtat materiale mjekësore? Në momentin që te Ministria e Shëndetësisë lind një shqetësim dhe ka një standard më të lartë materialesh që përtej këtij standardi nuk mund t'i tregtojnë këto materiale në RSH, aty shumë mirë mund të ulen palët dhe diskutojnë për ndryshimin e çmimeve. Ne nuk i përballojmë dot më, por t'i 2-fishosh çmimet me të njëjtat materiale, kjo do të thotë që të futet

2-fishi i parave në mënyrë abuzive në xhepat e disa njerëzve. Ky është mashtrim. Këtë emër ka dhe kështu duhet ta trajtojë Ministria e Shëndetësisë, se prandaj është çoban i qytetarëve shqiptarë.

Në momentin që janë bërë palë, ata janë në rregull, janë bërë protagonistë se shkuan në gjykatë, humbëm ne dhe fituan ata. Jo, nuk kanë çfarë të humbasin dhe çfarë të fitojnë. Ata kanë shpërdoruar detyrën, si ai që e ka ndërmarrë nismën, si ai që ka përgatitur dokumentin, si ai që e ka futur për diskutim.

Urdhëro, për pyetjen e zonjës Spahiu!

Klodiana Spahiu – Edhe një herë, po e ritheksoj kohën, sepse po insistohet te koha. Më 14 ka qenë mbledhja e Këshillit?

Antoneta Njehrrëna – Jo, më datë 6 ka qenë mbledhja e Këshillit, ku unë jam anëtare.

Klodiana Spahiu – Cili ka qenë qëndrimi juaj?

Antoneta Njehrrëna – Qëndrimi im ka qenë kundër, në lidhje me faktin që Urdhri s'ka të drejtë të nxjerrë një vendim për të përcaktuar tarifat për shërbimet shëndetësore, të cilat nuk janë kompetencë e Urdhrit, siç e tha edhe kryetari i komisionit, Urdhri vepron në bazë të Kodit të Etikës dhe Kodit të Deontologjisë Mjekësore dhe nuk mund të merret me shërbimin dhe me mënyrën e tarifimit të këtij lloji shërbimi. Ky ka qenë qëndrimi që unë kam mbajtur në këtë Këshill Kombëtar, ku, siç e theksova, kam vetëm një votë. Aty janë 25 anëtarë dhe pjesa tjetër ka shprehur mendimin e vet, siç e ka gjykuar.

Petrit Vasili – Po ministrja është njoftuar për këtë vendim nga ju?

Antoneta Njehrrëna – Po, patjetër, ajo është njoftuar për vendimin e këshillit.

Petrit Vasili – A thirri njeri nga Urdhri ministria për t'ua bërë të qartë që janë në shkelje dhe duhet të ndalen?

Antoneta Njehrrëna – Ministria priti zyrtarisht vendimin e asamblesë, i cili është vendim përfundimtar.

Petrit Vasili – Dakord, por një vendim ishte marrë në prezencën tënde.

Antoneta Njehrrëna – Vendimi për t'iu propozuar asamblesë për këtë ...

Petrit Vasili – Po, ai është vendim. Në këtë moment u njoftua ministrja dhe duhej t'u thuhej: keni marrë një vendim paraprak, të paligjshëm për të propozuar. A i thirrët?

Antoneta Njehrrëna – Që vendimi ishte i paligjshëm e shprehëm me argumente në atë komision.

Petrit Vasili – Ti ke vepruar në rregull. Po ministrja, a është njoftuar për këtë punë?

Antoneta Njehrrrena – Po, patjetër që është njoftuar.

Petrit Vasili – Në momentin që u njoftua ministrja, a i thirrët përfaqësuesit e Urdhrit dhe a u thatë se kanë marrë një vendim paraprak të paligjshëm? Çdo kryesi shprehet me një vendim. A kishte ndonjë vendim të shkruar? Ti nuk thua dot, që s'kishte vendim për t'iu paraqitur asamblesë.

Antoneta Njehrrrena – Po, do t'i bëhej propozimi.

Petrit Vasili – Bravo!

Për këtë vendim që ishte i shkruar, e zeza në të bardhë, pasi u njoftua ministrja a u thirrën kryetari i Urdhrit të Mjekëve dhe të tjerët dhe a u thatë se kishin marrë një vendim që do të shkojë në asamble dhe në kryesi? A u lajmëruan të ndalen me këtë veprim apo a ka pasur një komunikim shkresor, ku t'u thuhej që duhej të ndaleshin? Ka diçka të tillë apo nuk ka?

Klodiana Spahiu – Zoti Vasili, ju lutem, se po e kthejmë në një seancë gjyqësore! Duket sikur ne jemi trupi gjykues dhe ata janë të pandehur. Nuk ka asnjë lloj kuptimi ta vazhdojmë seancën kështu.

Ju lutem edhe një herë, se ajo po shpjegon shumë mirë, se çfarë ka bërë dhe se shkresa zyrtare ka ardhur në filan datë. Menjëherë pas shkresës zyrtare...

Petrit Vasili – Ta marr unë përgjigjen dhe më pas vazhdo ti!

Nuk ma zgjedh ti pyetjen se si e bëj unë. Ke marrë një detyrë të vështirë.

Klodiana Spahiu – Zoti Vasili, ju lutem ta lëmë të flasë!

Petrit Vasili – A ka pasur reagim shkresor për këtë nga ju?

Klodiana Spahiu – Jua tha, se reagimi shkresor i asamblesë ka ardhur më vonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Pra, mbas vendimit të kryesisë nuk ka pasur komunikim?

Antoneta Njehrrrena – Jo.

Petrit Vasili – Në rregull, e kam të qartë.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Ju lutem, edhe një herë përfaqësuesve të ministrisë! Ju keni dalë me një akt-padi në momentin që keni marrë reagimin me shkrim të Urdhrit të Stomatologëve, apo jo?

Antoneta Njehrrrena – Edhe sot e kësaj dite në ministri nuk ka një reagim me shkrim nga Urdhri i Stomatologëve. Nuk ka një shkresë të tyre për të përcjellë vendimin, që kanë marrë në asamblenë e datës 14.

Petrit Vasili –Vendimin e kanë marrë vesh nga mediet.

Urdhëroni, zonja Pampuri!

Oriola Pampuri – Unë e kuptoj sikletin tuaj, duke filluar që nga zëvendësministrja dhe të tjerët me radhë, sepse me të vërtetë është siklet. Edhe unë po të isha në vendin tuaj, do të gjeja 1001 arsye që të mos isha sot këtu në vend të ministres. Fakti që ministrja nuk është, për këtë u fol dhe nuk ka rëndësi që ta zgjasim, është akt i paprecedent, por që i përket asaj.

Fakti që u mor vendimi në Asamble, ministrja u njoftua, sepse të paktën nga eksperiencia ime në këta 2 vjet, nuk ka çështje e cila trajtohet dhe nuk njoftohet ministrja; nuk ka çështje për të cilën ndodh ose ka një ngjarje apo një vendim që merret në QSUT apo në të gjithë sistemin, për të cilin ministrja nuk është në dijeni. Merret një vendim në asamble për 2-fishimin e tarifave të shërbimeve stomatologjike, që edhe ky është totalisht i paprecedent.

Njoftohet ministrja, e cila nuk reagon për 2-fishimin e tarifave. Merret një vendim në asamble për 2-fishimin e tarifave të shërbimeve stomatologjike. Edhe kjo është totalisht e paprecedente. Njoftohet ministrja, e cila nuk reagon, por reagon menjëherë mbasi çështja bëhet shumë publike në medie. Ministrja nuk reagoi në rastin, kur duhet të reagonte.

A e di ministrja që në Shqipëri 16% e popullatës nuk ka shkuar asnjë herë te dentisti?

A e di ministrja që në Shqipëri 50% e popullatës nuk shkon te dentisti, sepse nuk ka para?

Pyetja është: Pse ky reagim i vonuar thjesht, për të bërë show?

Unë them me bindje, se nga gjithçka që u bisedua që e gjithë kjo që ka ndodhur, siç po ndodh me çdolloj vendimi tjetër, duke filluar nga koncesionet e deri te vendime të tilla, në momentin që bëhet publike ka një reagim thjesht për të bërë show dhe për të treguar që ne jemi jashtë dhe penalizohen disa persona që nuk kanë lidhje. Në fakt, për sa kohë ajo ka heshtur, vendimi është i ministrisë. Kjo është pyetja. Ndërkohë që shërbimet stomatologjike shtetërore janë jashtë çdo standardi dhe nuk kanë kushte, ju kërkoni dyfishim të tarifave; ndërkohë që nuk ofrohen shërbime, kërkohet të bëhen pagesa ekstremisht të larta; ndërkohë që shëndeti oral i shqiptarëve në Shqipëri është në një situatë kritike, ju kërkoni dyfishim të tarifave. Jua them juve, sepse ju jeni përgjegjës, prandaj mos e hiqni përgjegjësinë nga vetja si ministri. Për sa kohë ka pasur heshtje dhe reagim kur u bë publike, atëherë jeni po aq përgjegjës sa edhe Urdhri i Stomatologut.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Xhelilaj – Unë kam një merak si qytetar. Kur shkojmë për të marrë shërbimin te dentisti shikojmë të afishuar në mur një tabelë çmimesh. Kush e ka miratuar atë tabelë? Cili është roli i ministrisë? Ky vendim i marrë, që kryetari i komisionit e konsideron që atyre nuk ju takon, çfarë lidhje ka me ju si ministri? Në raport me situatën e stomatologjisë, cilat janë detyrat që ka Ministria e Shëndetësisë? Për cilat grupe ekziston sistemi i stomatologjisë?

Për sa i përket pjesës tjetër, pasi është bërë padia, situata është kundërshtuar. Këtu duhet vlerësuar kontributi shumë i madh i medias. Ku është pozicioni i ministrisë në këtë drejtim? Si ka funksionuar deri sot dhe si mund të ndërhyri ju me këtë kërkesë-padi për çmimet te Urdhri i Stomatologut?

Gjergji Koja – Faleminderit!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë!

Besoj se edhe me debatin që po bëhet këtu kemi arritur në një lloj kronologjie kohore edhe të veprimeve ose mosveprimeve, të veprimeve të paligjshme të Urdhrit të Stomatologut apo të reagimeve të ligjshme të Ministrisë së Shëndetësisë.

Së pari, nga vetë Kryetari i Komisionit u evidentua me të drejtë fakti që në Asamblenë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut Ministria e Shëndetësisë ka një votë dhe vlerë minimale në raport me mundësinë për të kthyer situatën. Pra, çfarëdolloj çmendurie që mund të miratohet në Asamblenë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë nuk ka mundësi ta kthejë mbrapsht.

Së dyti, informacioni, reagimi, shqetësimi dhe preokupimi politikëbërës dhe profesional i përfaqësueses së Ministrisë së Shëndetësisë pranë ministres së Shëndetësisë ka qenë i plotë dhe në nivelin e duhur profesional.

Padyshim që kemi të bëjmë minimalisht me një papjekuri sociale të Urdhrit të Stomatologut, sepse ka shkelur rëndë nenin 4 për sa i përket misionit dhe nenin 11 për sa i përket të gjithë aktivitetit të tij në raport me Kodin e Deontologjisë Mjekësore e me radhë. Urdhri i Stomatologut nuk ka asnjë tagër të vendosë çmimet.

Sot e kësaj dite që po flasim, edhe pse Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë është detyruar me ligj që të komunikojë zyrtarisht me Ministrinë e Shëndetësisë, edhe pse është i detyruar në bazë të një memorandum bashkëpunimi dhe mirëkuptimi që ka me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor që të njoftojë për çdo akt që ndërmerr, për çdo aktivitet të tij apo për çdo problematikë që lind nga aktiviteti i tij kontrollues apo licencues, nuk ka asnjë praktikë të tillë.

Pra, edhe sot vendimi është në media. Urdhri i Stomatologut e ka për detyrë ta sjellë pranë ministrisë, por nuk e ka sjellë.

Prandaj, në këtë drejtim unë mendoj që Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë hapat në kohë rekord. Nuk ka asnjë vonesë për sa u përket mundësive për ta kthyer në nulë vendimin për dyfishimin e çmimeve referencë që nuk i jep tagër ligjor askujt në Urdhrit të Stomatologut.

Në këtë drejtim, besoj se Urdhri i Stomatologut është ent publik. Duam apo nuk duam ne është palë. Në këtë ent publik, ashtu siç është bërë ligji, natyrisht që Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka një apo dy përfaqësues dhe minimumin e ndikimit në Asamblenë Kombëtare dhe në Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut. Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme, të domosdoshme dhe të mundshme në fraksionin e kohës për ta shndërruar në nulë një vendim, i cili vetëm cilësinë e shërbimit nuk garanton, por garanton ato që kryetari i komisionit tha me të drejtë. Padyshim që Ministria e Shëndetësisë ka reaguar shumë fuqishëm. Kjo ministri nuk mund të reagoje dot më shumë se kaq në këtë fraksion kohe. Bëri veprimet përkatëse, ka qenë një aktivizim paralel edhe me Autoritetin e Konkurrencës, që ka pezulluar përkohësisht këtë urdhër deri në përfundim të hetimit me të gjitha masat përkatëse që rrjedhin nga kjo, qoftë gjobën ndaj Urdhrit të Stomatologut, qoftë gjobën individuale ndaj çdo klinike stomatologjike. Besoj se shteti ka reaguar në një mënyrë adekuate.

Në fund të fundit, kjo papjekuri sociale totale e Urdhrit të Stomatologut ka nxjerrë në pah edhe probleme të tjera që kanë të bëjnë me përgjegjshmërinë për ngritjen e grupeve të punës që do të mundësojnë realisht njëherë e mirë kostifikimin e shërbimeve dhe në fund do të shikojmë se ku shkon çështja e çmimeve dysheme. Nuk ndërhyjmë në ekonominë e tregut (stomatologët mund ta vënë çmimin dysheme 5, 6 apo 200-fish), por për sa i përket çmimit dysheme që do të aplikohet në Tiranë, Korçë, Dibër, Kukës, Tropojë dhe kudo, padyshim që është tagër dhe pjesë e përgjegjësisë politikbërëse e Ministrisë së Shëndetësisë e cila ...

Kështu që, mendoj se në këtë mes ministria ka reaguar në mënyrën e duhur me të vetmen mundësi që mund të reagoje, duke pasur parasysh që edhe përfaqësuesit e saj në Asamblenë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut janë në minorancë të plotë. Zoti Vasili e tha me shumë të drejtë se çfarë kanë mundësi ata të bëjnë.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Kemi dy momente për të sqaruar.

Së pari, Ministria e Shëndetësisë absolutisht nuk ka qenë në krye të detyrës, pasi njoftimin zyrtar për çfarë po ndodhte në Urdhrit të Stomatologut e ka marrë në datën 6 me vendimin e kryesisë, i cili kishte një vendim tjetër përfundimtar. Nuk kishte asnjë rëndësi që pas vendimit të kryesisë, që mori përsipër të vinte një vulë dhe një firmë, të shkonte në këshillin kombëtar për një gjë tjetër. Që në atë moment Ministria e Shëndetësisë duhet të kishte ngritur në këmbë dynjanë për këta njerëz, të cilët nuk kanë papjekuri sociale, por janë shkelës të ligjit. Janë dy kategori të ndryshme. Nga ana sociale mund të jenë çfarë të duan, por janë shkelës të ligjit.

E treta, në rast se media nuk do ta kishte bërë këtë punë, procedurat administrative kanë 45 ditë kohë për t'u ankuar. Ankesa e Ministrisë së Shëndetësisë është bërë në ditën e 42-të. Në rast se media do ta nxirrte në fund të muajit lajmin, mundësitë ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë për t'u ankuar ishin zero. Mosreagimi pas marrjes së vendimit të kryesisë, për të cilin, siç u tha në komision, ministrja e Shëndetësisë është njoftuar, e ngarkon me përgjegjësi ministren e Shëndetësisë, pasi ishte një vendim në shkelje të ligjit dhe në dëm të drejtpërdrejtë të interesave të qytetarëve.

Po, zoti Spahia.

Bardh Spahia – Zoti kryetar, në datën 24 në mëngjes është bërë publike nga media, por edhe nga denoncimi i opozitës dhe konkretisht i Partisë Demokratike, vendimi i Urdhrit të Stomatologut i datës 6 dhjetor, pra, më shumë se një muaj e gjysmë përpara, për miratimin e listës së çmimeve dysheme të shërbimit dentar në Republikën e Shqipërisë. Pra, më shumë se një muaj e gjysmë më vonë ky fakt bëhet publik nga media dhe nga opozita shqiptare. Ndërkohë, pjesë e këtij vendimi të Urdhrit të Stomatologut ishin edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë.

Në datën 24, pas denoncimit publik të mediave dhe të Partisë Demokratike, vjen një deklaratë e ministres së Shëndetësisë, e cila thekson se Ministria e Shëndetësisë ka qenë kundër. Menjëherë i përgjigjemi me dokumentin e Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, në të cilin duket qartë që vendimi i datës 6 është marrë me 22 vota pro, 0 kundër dhe 2 abstenime. I kujtojmë publikut shqiptar që në këtë këshill Ministria e Shëndetësisë ka përfaqësuesin e vet, por ka edhe përfaqësuesin e Fondit të Sigurimeve.

Një muaj e gjysmë pas marrjes së këtij vendimi Ministria e Shëndetësisë nuk ishte kundër, por për miratimin e plotë të këtij vendimi të Urdhrit të Stomatologut, Ministria e Shëndetësisë kujtohet të bëjë një reagim mediatik duke mohuar votën pro këtij vendimi dhe pastaj vendimin tjetër të ministres për ta çuar në gjykatë vendimin e Urdhrit të Stomatologut.

Dëgjoj nga përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë të thonë se ministria reagoi në mënyrën më të mirë dhe më të shpejtë të mundshme. A mund të ma shpjegoni pak votën e ministrisë pro këtij vendimi dhe ku rezulton vota juaj kundër? Unë shikoj këtu të thuhet zero vota kundër. Ku është vota kundër e ministrisë? Si e shpjegoni votën kundër zero këtu? Ku është vota kundër e Ministrisë së Shëndetësisë? Nuk mjaftoi vendimi i datës 6 i Urdhrit të Stomatologut, por në datën 14 u mor edhe një vendim tjetër nga Asambleja e Urdhrit të Stomatologut dhe përsëri Ministria e Shëndetësisë në rastin më të mirë flinte gjumë, por tani në dritën e fakteve të pamohueshme vërtetohet që ka qenë palë në këtë vendim të Urdhrit të Stomatologut.

Cili ka qenë pozicioni zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë? Pse deklaroni që keni qenë kundër kur në dokument shënohet që nuk ka pasur vota kundër? Si qëndron e vërteta? Pse Ministria e Shëndetësisë detyrohet të mashtrojë opinionin publik në lidhje me qëndrimin e saj në votim?

E dyta, pse Ministria e Shëndetësisë nuk reagoi direkt ditën e votimit të këtij vendimi, qoftë edhe publikisht apo mediatikisht në pritje të shkresës zyrtare, siç mundoheni të justifikoheni ju? Të ishte deklaruar kundër këtij vendimi të paligjshëm. Ky është një vendim i paligjshëm dhe në shkelje të plotë të ligjit, i cili parashikon qartazi misionin e Urdhrit të Stomatologut, që është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit të stomatologut dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i këtij profesioni. Kaq është detyrimi ligjor i Urdhrit të Stomatologut.

Miratimi i një liste dysheme të çmimeve të ofrimit të shërbimeve dentare, në rastin më të mirë dyfishim i tyre nga ana e Urdhrit të Stomatologut, duhet të kishte krijuar një reagim të jashtëzakonshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, e cila përballë shkeljes së rëndë të ligjit nga një urdhër profesional ka detyrimin ligjor, qoftë edhe në pritje të shkresës zyrtare që thoni ju, të paktën mediatikisht të kishte dalë, të ishte distancuar. Por, siç është tashmë e qartë, faktet flasin. Vota e Ministrisë së Shëndetësisë në këtë listë ka qenë pro. Asnjë votë kundër nuk ka pasur.

Në fakt, këto përgjigje sot do të duhej t'i jepte ministrja e Shëndetësisë. Unë e kuptoj situatën e vështirë, sidomos të juristes, e cila e kupton shumë mirë se për çfarë po flasim. Prandaj kërkonim me insistim ministren e Shëndetësisë këtu, për t'iu përgjigjur, minimalisht, paaftësisë së saj. Është evidente që kjo nuk është vetëm çështje paaftësie, por është çështje përfshirjeje qartazi e Ministrisë së Shëndetësisë në aprovimin dhe miratimin e kësaj liste, në shkelje të plotë të ligjit, i cili nuk i jep asnjë kompetencë Urdhrit të Stomatologut për ndërhyrje në çmimet e ofrimit të shërbimeve.

Kush do të na e japë këtë përgjigje?

Pse ju thoni se ministria ka qenë kundër, ndërkohë që këtu nuk shohim votë kundër? Pse mashtrohet opinionimi publik? Këtë përgjigje, në fakt, e donim nga ministrja.

Mira Rakacolli – Faleminderit!

Po dëgjojmë me shumë durim, për shkak edhe të sensibilitetit që ka...

Petrit Vasili – Një minutë, zonja Rakacolli.

Zonja Bode dhe më pas zonja Rakacolli.

Edlira Bode – Faleminderit!

Kam diçka shumë të përmbledhur, duke qenë se edhe përgjigjen mund të na e jepni njëherësh.

Me sa po kuptoj, debati u koncentrua nëse ministria duhet të reagojë para apo pas shkresës.

Pyetja ime për këtë është: çfarë mund të bënte ministria pa ardhur vendimi me shkrim nga Urdhri i Stomatologut?

Së dyti, nëse do të kalonte koha e ankimit, çfarë reagimi do të kishim? Pra, Urdhri i Stomatologut mund të mos e dërgonte këtë shkresë edhe për një muaj e gjysmë tjetër.

Çfarë reagimi do të kishim ne dhe si do të kishte përfunduar kjo histori? Kjo për të ditur edhe se çfarë mund të ndodhë në të ardhmen, sepse një urdhër profesional, që e shkel ligjin në këtë mënyrë dhe nuk dërgon shkresë në ministri, mund ta bëjë këtë përsëri.

Çfarë mekanizmi kemi ne për ta parandaluar këtë?

Faleminderit!

Petrit Vasili – Zonja Rakacolli, keni fjalën.

Mira Rakacolli - Po thosha se po dëgjojmë me shumë durim debatin e madh që po bëhet në këtë komision, edhe për shkak të sensibilitetit të jashtëzakonshëm që ka.

I kuptojmë edhe emocionet që shfaqen këtu, por do të thosha se janë pak të tejkaluara, sepse të gjitha konkluzionet që po nxirren për qëndrimin e ministrisë, ndoshta të influencuara edhe nga emocioni, po e tej kalojnë vlerën e tyre.

Të gjitha komentet po përmbledhen te fakti që ministria ka reaguar vonë. Ta shikojmë pak më ndryshe problemin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ju kam dëgjuar me shumë durim! Kam dëgjuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të dal edhe aty.

Kam dëgjuar në mënyrë të përsëritur edhe lëndime pa të drejtë dhe po e marr vetëm tani fjalën. Mendoj se ju takon të më dëgjoni me po aq durim sa kam ofruar.

Petrit Vasili - Po, zonja Rakacolli, mund të vazhdoni!

Mira Rakacolli - Qëndrimi publik i ministrisë ka qenë dhe është tejet i distancuar nga ai vendim, sepse, po të shohësh urdhrin që ka nxjerrë Urdhri i Stomatologut për tarifat e reja, mbështetet pikërisht te ligji nr. 127, i cili nuk i jep kompetencë Urdhrit për të përcaktuar tarifat. Pra, edhe baza ligjore, së cilës i është referuar Urdhri i Stomatologut, baza ligjore e cituar, nuk ia jep fare atë të drejtë.

Petrit Vasili – Kjo bazë ka qenë edhe në vendimin e datës 6, zonja Rakacolli.

Mira Rakacolli - Kjo nuk ka koment. Nuk ka absolutisht asnjë lloj komenti për t'u bërë për paligjshmërinë e këtij vendimi...

Petrit Vasili – Ka qenë edhe kur ka qenë marrë vendimi i parë. Mund të ishte reaguar që atëherë.

Mira Rakacolli – Baza ligjore që ka cituar ligji dhe baza ligjore e caktuar me firmë dhe vulë nga presidenti i Urdhrit të Stomatologut nuk ia jep absolutisht të drejtën që... Misioni i stomatologut është ai që u citua disa herë këtu, që ka të bëjë, në radhë të parë, me ngritjen e standardeve profesionale të Urdhrit të Stomatologut, me rregullimin e marrëdhënieve me pacientët, me mbrojtjen e tyre përballë kequshtrimit të profesionit të stomatologut.

Petrit Vasili – Kjo është e qartë.

Mira Rakacolli – Kjo është shumë e qartë.

Në datën 6 është marrë një vendim i paligjshëm i kryesisë, për ta çuar në Këshillin Kombëtar dhe në asamble. Pra, këtu ministria nuk mendoj se do të ndikojë dhe të thotë se nuk do ta çoni në asamble.

Për afatin ligjor të ankimimit, kam Netën këtu dhe mund të përgjigjet konkretisht. Afati i ankimimit, me sa di, fillon nga momenti që merr njoftimin zyrtar, në një kohë kur po themi se zyrtarisht ministria akoma nuk e ka marrë vendimin zyrtar.

Petrit Vasili – Po pse duhet ta njoftojë ministrinë, zonja Rakacolli?! Jua kanë shpjeguar gabim.

Mira Rakacolli – Këtë detyrim ia jap neni 7 i ligjit.

Petrit Vasili - Mira, kjo nuk është çështje neurologjie. Kjo është çështje administrative. Koha e ankimit fillon nga dalja e vendimit. Kë do të njoftonte? Nuk ishit palë, që t'ju njoftonte.

Mira Rakacolli – Neni 7 i ligjit për stomatologun, që e cituat edhe ju, i jep Urdhrit detyrim, që, për vendime që kanë të bëjnë me shërbimet, konkretisht, me shërbimin ndaj pacientit, duhet të njoftojnë Ministrinë e Shëndetësisë.

Petrit Vasili – Nuk ka, se e ka të paligjshëm. Ai nuk ka të drejtë ta bëjë. Kjo është tautologji, Zonja Rakacolli.

Ju thoni që në krye të herës se është një vendim i paligjshëm. Kë do të njoftojë një vendim i paligjshëm? Kush është partneri i ligjshëm që duhet të njoftojë...? E lëmë këtë arsyetim, se është fare pa bazë. Juridikisht është zero. Ky është nul.

Mira Rakacolli – Po, vendimi që ka marrë Shoqata e Stomatologëve është nul.

Petrit Vasili – Këtu nuk ka palë, po jua them prapë.

Mira Rakacolli – Ministria nuk ka se si të jetë palë, se këtu po akuzohet Ministria e Shëndetësisë...

Petrit Vasili - Ministria duhet t'i padiste për shpërdorim detyre dhe për thyerje të ligjit, jo për të shfuqizuar tarifën.

Mira Rakacolli – Ministria ka reaguar menjëherë, duke bërë padi në Gjykatën Administrative.

Petrit Vasili - Mirë, mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëre ta mbarojë! Kur të thotë se mbaroi...

Vazhdo, zonja Rakacolli.

Mira Rakacolli – Për pyetjen që bëri zonja Edlira Bode, se çfarë mund të bënte ministria pa ardhur urdhri, ministria, pa ardhur shkresa, nuk mund të vepronte në mënyrë ligjore shkresore.

Petrit Vasili – Po mbas vendimit të datës 6, përse ministria nuk komunikoi me askënd? Pse nuk i tha: “Ndaluni”?

Kishte një vendim. Ishte zonja atje dhe informoi ministren. Ajo thotë: “Informova ministren”.

Mira Rakacolli – Zonja, në mënyrë të detajuar ligjore, i shpjegoi Urdhrit të Stomatologut se nuk ka tagër ta marrë këtë vendim.

Petrit Vasili - Më fal, të të bëj një pyetje: nëse misionin e kishit kryer, atëherë përse e padisni?!

Mira Rakacolli – Kë padisim? Patjetër që do ta padisim, përderisa...

Petrit Vasili – Jo, mos e padit. Ia shpjeguat në datën 6.

Mira Rakacolli – Përderisa ky vendim doli mbas ...

Petrit Vasili – Po rrini tani, mos mbroni të pambrojtshmen! Mos u bëni qesharakë fare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardh Spahia – Ishte pyetja ime dhe nuk mora përgjigje.

Petrit Vasili – Për cilën pjesë të pyetjes?

Bardh Spahia – Tendenca për të dalë në mbrojtje të të pambrojtshmes ju implikon direkt dhe ju bën pjesë të atij vendimi.

Më vjen keq që gjendeni në pozicionin për të mbrojtur vendimin e ministres dhe të Ministrisë së Shëndetësisë, në shkelje të plotë të ligjit!

Ju mundoheni të justifikoni veprimet dhe qëndrimet tuaja në shkelje të plotë të ligjit. Bëheni edhe ju shkelës të ligjit.

Nuk mora përgjigje për pyetjen time të thjeshtë: ku është vota kundër e Ministrisë së Shëndetësisë?

Në dokument lexoj se nuk ka pasur asnjë votë kundër. Për më tepër, fakti që juristja e ministrisë e deklaroi se ka qenë në kontakt të vazhdueshëm, ka njoftuar ministren, më bën të mendoj se ky ka qenë një vendim i koordinuar më së miri me ministren e Shëndetësisë dhe një qëndrim zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë.

Edhe një herë, ju lutem, jepini përgjigje pyetjes sime! Ku është vota kundër e përfaqësuesit të ministrisë?

Mira Rakacolli – Personi që ka të drejtën e votës atje, është në krahun tim dhe do t'jua kthejë tani përgjigjen.

Bardh Spahia – E more përsipër ti të ma japësh përgjigjen, mbasi...

Petrit Vasili – Lëre, se do të torturojnë Netën ata, e kanë ndarë mendjen.

Bardh Spahia - Po i lënë Netës një vendim që e kanë marrë politikisht drejtuesit e...

Mira Rakacolli – Neta është personi fizik, që është përfaqësues...

Petrit Vasili – Po, po, Neta është ministrja e Shëndetësisë sot! Po i bini në qafë kot!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro, Neta.

Antoneta Njehrrëna— Për pyetjen se përse Urdhri vetëm me firmën e kryetarit ka nxjerrë atë vendim dhe nuk ka shpallur votën time kundër, kjo është përgjegjësi e Urdhrit. Urdhri mund të japë shpjegimet dhe, në dijeninë time, i ka dhënë.

Unë jam këtu për të thënë se vota ime ka qenë kundër. Kam argumentuar se nuk është kompetencë e Urdhrit të nxjerrë këtë lloj vendimi. I kam kërkuar Urdhrit që, për vendime që lidhen me shërbimin stomatologjik, të ketë komunikim me Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo është ajo që mund t'ju them për votën time. Vota ime ka qenë kundër në mbledhjen e datës 6.

Petrit Vasili – Dakord.

Me një fjalë, këtu kemi edhe elementë të...

Bardh Spahia - Të veprës penale.

Petrit Vasili – ...të manipulimit të votimit. Kjo është shumë e rëndë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shkurt, të lutem!

Më pas do të flasë zonja Spahiu.

Floida Kërpaçi – Duhet ta bëjmë të qartë dhe për qytetarët që na ndjekin se si ka qenë situata. Kemi dy shkelje shumë të rënda ligjore.

Së pari, kemi shkelje të ligjit nr.127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.

Së dyti, kemi shkeljen, për të cilën u shpreh edhe Autoriteti i Konkurrencës, e nenit 4 dhe 69 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Kolegia ime, Bode, shtroi një pyetje: çfarë mund të bëjë Ministria e Shëndetësisë?

Çfarë mund të bëjë Ministria e Shëndetësisë, kur në Këshillin Kombëtar ka pasur përfaqësuesit e saj? Se çfarë ka bërë, e kemi përgjigjen. E kemi këtu dokumentin zyrtar. Ka heshtur.

Edhe më e rëndë është se ministrja e Shëndetësie ka deklaruar se ne kemi dhënë votën tonë kundër, kur, në fakt, ky është një mashtrim i madh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, nuk të ndërpreva!

Unë kam dokumentin përpara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërprisni!

Ta mbaroj fjalën? Po marr kohën time.

Petrit Vasili – Po, vazhdo, zonja Kërpaçi.

Floida Kërpaçi – Janë shkelur dy ligje shumë të rëndësishme, për të cilat Ministria e Shëndetësisë nuk ka reaguar. Ky është një reflektim se si kjo qeveri po qeveris me mashtrime dhe pa transparencë.

Mungesa e zonjës ministre sot në komision... Ne kemi bërë një kërkesë në hartimin e kalendarit. Ka qenë kërkesë e posaçme që ministrja të ishte sot në komision dhe të mbante përgjegjësi, por, me sa duket, kjo është mënyra se si ju qeverisni.

Zoti Sandër Lleshaj nuk vjen në komision për të folur për dhunën ndaj studentëve, ministrja nuk vjen për të folur për këtë vendim, që është marrë në mënyrë antiligjore. Kjo është mënyra se si qeverisni ju dhe për këtë do të mbani përgjegjësi.

Mira Rakacolli – Cila është pyetja?

Floida Kërpaçi – Është fakt që ju keni mashtruar...

Mira Rakacolli – Pyetjen, të lutem!

Floida Kërpaçi – Më fal, unë mund të bëj edhe koment!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kisha të njëjtin shqetësim që pati edhe kolegu im, zoti Bardhi.

Si e shpjegoni ju deklaratën nga ministrja e Shëndetësisë, ku thuhet se ju keni mbajtur qëndrim kundër, kur, në fakt, në dokumentin zyrtar nuk ka asnjë votë kundër?

Pse nuk pati një deklaratë zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë më 6 dhjetor 2018 dhe që në atë moment të kishte një kallëzim penal për këtë procedurë antiligjore, ku shkelen dy ligje, që unë i citova pak më sipër?

Pse nuk pati një reagim që në atë moment, por u desh të bëhej mediatike dhe të kuptohej një muaj më vonë se çfarë po ndodhte që të kishte një deklaram? Kisha këto pyetje dhe kërkoj një adresim për këto.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Kam edhe një pyetje: a ka përfaqësues nga Fondi i Sigurimeve në grupin që është këtu?

Desha të bëj një pyetje. Kjo vlen për ju, zonja zëvendësministre. Ju e dini se te këshilli kombëtar ka edhe një përfaqësues nga Fondi i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Unë e kuptoj që, ju, padrejtësisht, ia ngarkoni të gjitha juristes, e cila nuk ka as tagrin politik, as ekzekutiv, që të marrë këtë ngarkesë, por e keni ekspozuar dhe ne nuk kemi çfarë të bëjmë. Minimalisht, duhet të ishte edhe ajo. Ju, me mirëkuptim, meqë nuk ishit ministri protagoniste, duhet të thërrisnit edhe përfaqësuesin përkatës nga Arsimi i Lartë i Shqipërisë, si institucion partner, sepse janë 3 përfaqësues që nuk janë të Urdhrit të Stomatologut, por janë *ex officio*, pra vendosen nga ministrinë për të qenë syri dhe veshi, në kuptimin e mirë të fjalës, i legjislacionit. Me këta konsultoheni? Keni informacion? E ka lajmëruar Fondin përfaqësuesi i Fondit? Të paktën, siç thuhet në buxhet, Fondi është një nga financuesit më të mëdhenj të shërbimit shëndetësor, pavarësisht nga mënyrat e organizimit. Unë nuk i shikoj. Unë shikoj dy zotërinj që kanë ardhur, por nuk kanë lidhje me çështjen, prandaj ju sugjeroja të rishikoni edhe përfaqësimin, por ministria, sërisht me kokëfortësi, vazhdoi të krijonte këtë gjë, sepse mund të kishin shpjegime të tjera.

Pyetje e përsëritur, për të mbetur edhe në memorien e misionit që ka ky komision për të sqaruar çështjen: çfarë e ndali Ministrinë e Shëndetësisë që të reagoje me shkrim për vendimin e Këshillit Kombëtar të datës 6? Këshilli Kombëtar është një nga organet drejtuese me të cilat përbëhet kjo strukturë. Zonja përfaqësuese e sqaroi. Madje, në mënyrë normale, duhet që ministrin ta sqaronin të gjitha bashkë, edhe përfaqësuesja e ministrisë, edhe e Fondit, pasi një ministri është tutela ekzekutive. Dhanë një njoftim për një vendim të tillë. Çfarë e mbajti dorën e ministrisë, që nuk reagoi as me shkrim, as me deklaratë publike? Deklarata publike ishte për të qetësuar opinionin, por, së paku, të reagohej me shkrim. Çfarë e ndali të mos reagoje, sepse për këtë është e qartë që ka pasur informacion. Pse nuk u thirrën? Të komunikohesh me shkrim dhe të thirrëshin përfaqësuesit e Urdhrit të Stomatologëve e të thoshin: këtu, këtu këtu. Në rast të kundërt, të njoftonin: ne do të marrim masa të tjera për ju, do t'ju akuzojmë për shpërdorim të qartë në detyrës dhe shkelje të ligjit. Ndaluni këtu dhe pikë, mbaroi. Nëse doni mblidheni Këshillin Kombëtar, po njoftoj opinionin publik. Ky është qëndrimi i ministrisë. Është kjo gjë, ky urdhër është në këtë mënyrë. Shteti të marrë masa për këtë. Nuk është hezituuar për gjëra të tjera, se nuk dua të dal asnjë centimetër jashtë çështjes së sotme, nuk dua të bëj asnjë gram më tej konsiderata, qofshin këto administrative apo politike. More një lajm, po shkelet ligji ashiqare. Përfaqësuesi yt, që është atje, është pikërisht për të treguar gjithçka. Ta ka treguar dhe ti nuk e lëviz gishtin. Çfarë emri do? T'i vë emrin papërgjegjshmëri? Është shumë e rëndë. T'i vë emrin ortakëri? Më keq akoma. Hajde, ta gjejmë bashkë, dhe t'i vëmë emrin, sepse jemi në këtë dëgjese për t'i vënë një emër. Dua të di pse

nuk ka pasur reagim për këtë punë? Po të reagohej në datën 7 apo në 8, Urdhri i Stomatologëve nuk do të guxonte kur ta merrte vesh i gjithë opinioni publik. Këta mund t'i thoshin: ndaluni, mos shkoni përpara, bëni komunikim me shkrim! Në rast se në datën 14 do të merrej vendimi tjetër, do të kishin tjetrin, dhe këta nuk do të shikonin në Gjykatën Administrative, do të shkonin në vend tjetër, do të merrej prokuroria me ta. Ndërsa kështu i keni vënë ata në komoditet të paparë, palë protagoniste.

Gjergji Koja – Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Prisni, të marr përgjigjen!

Gjergji Koja – Gjykoj se shqetësimi juaj, i të gjithë deputetëve këtu, edhe nga krahu i majtë, edhe i djathtë, është i njëjtë, për të gjithë qytetarët, për tentativën e papjekurisë sociale të Urdhrit të Stomatologëve për të rritur në mënyrë antiligjore çmimet dysheme të ofrimit të shërbimit shëndetësor stomatologjik. Besoj se edhe nga ky debat sot do të jetë shumë të qartë, dhe qytetarët duhet të qetësohen, që nuk do të ketë asnjë rritje të çmimit dysheme të atij vendimi nul. Vendimi që ka marrë Asambleja Kombëtare e Urdhrit të Stomatologëve është nul, nuk zbatohet, sepse nuk ka tagër ligjor dhe për këtë të jemi të gjithë të qartë dhe të qetë, gjithashtu.

Zonja ministre e Shëndetësisë, pa dashur të bëj avokatorin e saj, nuk e kam bërë dhe nuk do ta bëj asnjëherë, ka reaguar fuqimisht edhe me deklaratë në pozicionin e ministres së Shëndetësisë në raport me këtë tallava që lindi për çmimet që ka rritur Asambleja Kombëtare e Urdhrit të Stomatologut. Pasi dha deklaratën edhe publikisht, në cilësinë e titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bëri veprimet e mëtejshme ligjore, që u sqaruan mjaft mirë nga përfaqësuesit e ministrisë edhe për sa i përket padisë në gjykatë. Pra, në respekt të një marrëdhënieje shkresore zyrtare, për një vendim shumë të rëndësishëm që tentoi të merrte Urdhri i Stomatologut, për të cilin nuk ka tagër, për dyfishim çmimesh referencë, u ndoq rruga e nevojshme ligjore për ta çuar në gjykatë.

Petrit Vasili – Gjergji, unë nuk dua të bëj debat me ty, vëlla. Ti e di që është gjëja e fundit në botë që dua të bëj.

Gjergji Koja – As unë nuk dua të bëj.

Petrit Vasili – Po bëj një pyetje shumë të qartë dhe dua të marr përgjigjen.

Gjergji Koja – Të lutem!

Petrit Vasili – Gjergji!

Gjergji Koja - Nuk po të ndërpres.

Petrit Vasili - Nuk është për të ndërprerë.

Gjergji Koja – Përderisa më keni dhënë fjalën, më respektoni! Më dëgjoni!

Petrit Vasili – Është e drejta jote ta bësh pjesën e komenteve. Unë po të bëj një pyetje.

Gjergji Koja – Jo për komentet.

Petrit Vasili – Unë po të bëj një pyetje. Çfarë e pengoi...

Gjergji Koja – Unë po flas brenda pikës.

Petrit Vasili - Më dëgjoni deri në fund.

Gjergji Koja – Po të dëgjoj, por edhe unë po flisja.

Petrit Vasili –Prit, të jap përgjigje.

Në datën 6, është e qartë për të gjithë tavolinën, ministrja ka marrë njoftim për këtë punë. Unë kam një pyetje.

Gjergji Koja – Çfarë njoftimi ka marrë?

Petrit Vasili – Është edhe pyetja jote, por ti nuk e bën dot, sepse ne jemi në një pozicion tjetër tani.

Gjergji Koja – Çfarë njoftimi ka marrë? Njoftim zyrtar nuk ka. Për këtë po flasim.

Petrit Vasili – Ka pasur një vendim të Këshillit Kombëtar.

Gjergji Koja – Por nuk ka njoftim zyrtar, zotëri.

Petrit Vasili – Mos vazhdo tani!

Gjergji Koja – Shteti punon me shkresa, nuk punon shteti se lajmi doli te filan portal. Nuk ka marrë njoftim zyrtar. Po flasim për njoftime zyrtare, zotëri.

Petrit Vasili – Vendimi është pjesë.

Gjergji Koja – Nuk ka njoftimin zyrtar, që të thotë të ngresh çmimin dysHEME dyfish.

Petrit Vasili – Po flet kot tani, ta them sinqerisht.

E ke parë, apo nuk e ke parë ligjin?

Gjergji Koja – Nëse unë jam i detyruar t'ju them juve që flisni plot, e mbyll gojën, nuk flas më.

Petrit Vasili – E ke parë ligjin, apo jo?

Gjergji Koja – Nuk është kjo çështja.

Petrit Vasili – Është anëtar i Këshillit Kombëtar.

Gjergji Koja – Të lutem, ku ka ardhur shkresa? Ka ardhur njoftim zyrtar nga ministria?

Petrit Vasili – Ta shpjegoj unë.

Gjergji Koja – Urdhri është palë.

Urdhri i Stomatologut duhet të sjellë njoftimin zyrtar. Ky është vendim i Asamblesë Kombëtare të Ministrisë së Shëndetësisë. Ky është vendimi i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

Petrit Vasili –Më fal. E bëre shpjegimin?

Gjergji Koja – ... Memorandum bashkëpunimi. Si veprohet kjo?

Petrit Vasili –Më fal, ta them unë.

Gjergji Koja – Atij mund t’i teket të bëj çdo lloj çmendurie dhe t’i nxjerrë në medie.

Petrit Vasili – Do përgjigje?

Ndalu pak të jap përgjigje.

Gjergji Koja – Çmendurirat, kur bëhen, bëhen zyrtarisht me vulë.

Petrit Vasili – Ndalu, pra, po të them!

Ta them unë si është.

Qetësohu dhe merre me terezi, sepse edhe Mira kishte hallin e emocionalitetit.

Gjergji Koja – Unë i qetë isha, ti më ndërpreve fjalën.

Petrit Vasili – Jo, nuk po të ndërpres fjalën.

Gjergji Koja – Mos më ndërpre!

Petrit Vasili - Për ta ditur, në ligjin e Urdhrit të Stomatologëve përcaktohet qartë që Ministria e Shëndetësisë ka përfaqësues. Siç e di ti më mirë nga të gjithë, çdo përfaqësues në një forum të caktuar ka të drejtë të marrë kopjen e vendimeve që merren aty, për të cilat voton pro, kundër apo abstenon. Ky është një e drejtë që buron nga qenia në një forum, të cilën e ka të përcaktuar me ligj, dhe në fund të mbledhjes ka të drejtën të marrë vendimin. Antoneta, nuk u mor vendim në datën 6, për t’ju përcjellë asamblesë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, u mor një vendim në atë mbledhje dhe Këshilli Kombëtar vendosi t’ia paraqesë Asamblesë këtë gjë. Bravo! Bravo, pra! Ky është vendimi. Ti ndërhyt kot për këtë punë.

Gjergji Koja – Para asamblesë, nuk është ...

Petrit Vasili – Ky vendim ...

Gjergji Koja – Jo, nuk është vendi ky. Mos u merrni me lodra fjalësh. Është një vendim i Asamblesë. Asambleja mund ta rrëzonte sërish, e amendonte sërish. Mori një vendim për ta përcjellë, për ta votuar në asamble.

Petrit Vasili – Mos bërtit kot, sepse nuk je gjëkund!

Në momentin që u mor ky vendim, për çfarë jepet e drejta?

Gjergji Koja – Për ta diskutuar asambleja.

Petrit Vasili – Po, që të marrë shqetësimet.

Unë po pyes, si reagoi ministrja kur e mori vesh këtë gjë?

Gjergji Koja – Më fal, cilën gjë?

Petrit Vasili – Mori lajmin.

Gjergji Koja – Nuk jemi ende tek Urdhri i Stomatologut. Jemi tek Asambleja. U mor një vendim këtu për ta çuar në asamble. Shkoi në asamble.

Petrit Vasili – Po, këtu jemi.

Gjergji Koja – Ku e ke si reagon ministrja? Jemi në Asamblenë e Urdhrit.

Mira Rakacolli – Jo, nuk ka në Asamble. Në Këshill Kombëtar, jo në Asamble.

Petrit Vasili – Në Këshill Kombëtar.

Mira Rakacolli – Po.

Petrit Vasili – Bëni sikur nuk kuptoni.

Ka marrë një sinjal. I thuhet ministres, në Këshillin Kombëtar, ku unë bëj pjesë, zonjë, u shkel ligji. E njofton. Këtë nuk e kupton?

Gjergji Koja – Në asamble ka ...

Petrit Vasili – Ti ke ardhur të bësh avokati. Rri, se nuk është në standardin tënd.

Ka dëgjuar që shkelet ligji dhe nuk ka gjë, le të shkelet, apo jo?

Gjergji Koja – Avokati kam bërë më parë.

Petrit Vasili – Lëre këtë muhabet.

Klodiana Spahiu – Ju lutem!

Petrit Vasili – Zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – Komisioni ynë mbron qytetarët, Urdhrin e Stomatologëve dhe çdo njeri që kemi detyrë ta mbrojmë. Ne nuk bëhemi palë me askënd. Për të qetësuar edhe situatën, ju duhet të kuptoni diçka. Doni të ndizni zjarr, kur nuk keni dru.

Petrit Vasili – Nuk po ndezim zjarr, lëre këtë punë.

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar i komisionit, edhe një herë. Për të gjithë anëtarët...

Petrit Vasili – Nëse zbatimin e ligjit ti e ke çështje zjarri, e ke në rregull.

Klodiana Spahiu – Për të gjithë anëtarët e komisionit...

Petrit Vasili – Mos e zbatoni ligjin, nuk ka problem. Kot e kemi miratuar.

Klodiana Spahiu – Edhe një herë, që ta kemi të qartë.

Petrit Vasili – Ne e kemi miratuar ligjin e Urdhrit, apo jo? E kemi bërë bashkë këtë?

Klodiana Spahiu – Më lini të mbaroj!

Deri më sot që flasim në këtë tryezë, jo vetëm që nuk është marrë asnjë vendim që mund të penalizojë qytetarët, por përkundrazi, kemi dy vendime të marra, një akt padi dhe një pezullim, që është bërë nga Autoriteti i Konkurrencës.

Petrit Vasili – Falë medias.

Klodiana Spahiu – Ju vazhdoni...

Edhe një herë, politikisht ne mund të rrimë deri në mëngjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi dy orë që po diskutojmë për diçka që nuk ekziston.

Jo, dua të mbaroj fjalën, Bardhi.

Petrit Vasili – Po, të mbarojë.

Klodiana Spahiu – Nuk po ju ndërpres.

Po diskutojmë dy orë për një fakt që nuk ekziston, që është ireal dhe po ju themi se kjo është e pezulluar. Ne, si anëtarë të Komisionit të Shëndetësisë, dhe ju si kryetar, duhet të kujdesemi që shërbimi stomatologjik t'u ofrohet sa më mirë qytetarëve dhe ofrimin e një shërbimi stomatologjik sa më të mirë ndaj qytetarëve nuk e rregullon rritja e çmimeve, por e rregullon ...

Petrit Vasili – Këtë mendojmë ne.

Klodiana Spahiu – Nuk është rritur asgjë, zoti Vasili. Po ju themi se është dëshira e tyre. Ne duhet të jemi në mbështetje edhe të qytetarëve, por edhe të Urdhrit të Stomatologëve, sepse ata nuk janë as armiq të tanë, nuk janë as mashtrues.

Petrit Vasili – Jo, nuk kemi punë fare.

Klodiana Spahiu – Ata janë ...

Petrit Vasili – I more përsipër?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Klodiana Spahiu – Bardhi, profesionistët ofrojnë shërbimin. Për gabimin që kanë bërë, do të përgjigjen para gjykatës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Bardh Spahia – Është bërë një shkelje ligji dhe ju po tregoni që jeni palë në këtë shkelje ligji.

Petrit Vasili – A e tha ajo në shkelje ligji?

Bardh Spahia – Mbrojtja që i bëni shkeljes së ligjit, ju bën automatikisht palë.

Klodiana Spahiu – A ka mundësi të mbaroj fjalën, zoti kryetar, dhe më pas të vazhdojë ai?

Bardhi, deklaratat...

Petrit Vasili – Mos e quaj Bardhi ...

Klodiana Spahiu – Zoti Bardhi.

Petrit Vasili – Jo, në kuptimin të mos i referohesh, që të mos futeni në debat.

Klodiana Spahiu – I kam dëgjuar deklaratat që keni bërë çdo ditë.

Nëse do të kthehemi te logjika, ne duhet të garantojmë për qytetarët shqiptarë një shërbim stomatologjik sa më lart standardeve që janë aktualisht dhe ju e dini shumë mirë që ky Urdhër dhe këta profesionistë punojnë në mënyrë të vazhdueshme për të arritur këto standarde. Rritja abuzive e çmimeve dysHEME, që ata kanë pretenduar nuk ka ndodhur dhe nuk do të ndodhë.

Petrit Vasili – Shumë mirë.

Klodiana Spahiu – I gjithë ky debat që bëjmë ne këtu...

Petrit Vasili – Është debat i kotë.

Klodiana Spahiu – Është një pikë uji, me të cilën ju doni të bëni vorbullën e madhe.

Petrit Vasili – Të them diçka.

Klodiana Spahiu – Deklarata e ministres, e gjithë përfaqësuesve të ministrisë, e Inspektoratit dhe e Autoritetit të Konkurrencës, që ka fuqinë për të kontrolluar dhe për ta pezulluar këtë çështje deri në hetim 3-mujor, në mënyrë të vazhdueshme ka qenë e qartë, që nuk ka për të ndodhur kjo gjë dhe ne nuk duhet të dezinformojmë qytetarët.

Petrit Vasili – Jo, nuk po i dezinformojmë fare. Nuk i themi që po ndodh.

Klodiana Spahiu – Unë, si përfaqësuese e Grupit të Partisë Socialiste dhe si nënkryetare e komisionit, do t'ju kërkoja juve shumë miqësisht të bëjmë diçka tjetër, që, ajo që është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, dhe siç zbatohet për Urdhrin e Farmacistëve, për të cilin kemi punuar pa fund, edhe anëtarët e opozitës, që në atë kohë mund të kenë qenë në maxhorancë, kanë një kontribut shumë të vyer, duhet të arrijmë të vendosim të njëjtin standard, që të mos hyjë më asnjë

produkt stomatologjik që përdoret në stomatologji pa qenë i akredituar, siç e kërkojnë ata. Kjo është puna që duhet të bëjmë ne.

Për sa i përket rritjes së çmimit, kërkohet standard. Nëse ne do të punojmë të gjithë bashkë me ministrinë për të mirën e qytetarëve, duhet bërë një kostifikim, që mund ta bëjë Ministria e Shëndetësisë, që do të shërbejë si bazë dhe si dysheme edhe për të gjithë Urdhrin e Stomatologëve.

Petrit Vasili – Është objekt i një çështjeje tjetër.

Klodiana Spahiu – Një minutë!

Petrit Vasili – Bëjmë një dëgjese tjetër për këtë gjë.

Klodiana Spahiu – Unë do ta mbaroj fjalën time.

Petrit Vasili – Po.

Klodiana Spahiu – Kjo është gjëja më e nderhme, më korrekte, që mund të bëjmë ne si komision.

Për të bërë luftë politike, sepse po afron data 16 apo për arsye të tjera, mund të bëjmë si të doni ju. Më e mira është kjo. Ne si Parti Socialiste mendojmë se ministria e ka marrë vendimin e vet.

Petrit Vasili – E ka marrë vendimin.

Klodiana Spahiu – Përderisa është në gjykatë...

Petrit Vasili – Ju lutem, mos hyni në debat!

Klodiana Spahiu – Për të vendosur nëse duhet të shkojmë në Gjykatën Penale apo në Gjykatën Administrative, mendoj se nuk është tagri ynë.

Petrit Vasili – Dakord.

Klodiana Spahiu – Kushdo të jetë ministër, e merr vet vendimin nëse do ta çojë në prokurori të gjithë Urdhrin e Stomatologëve apo në Gjykatën Administrative.

Opinionin ynë personal është që Gjykata Administrative...

Petrit Vasili – Këtë e përcakton ligji, nuk e përcakton dëshira e ministrit.

Klodiana Spahiu – Ju lutem, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Dëshira e përcakton këtë?

Klodiana Spahiu – Zoti Vasili, të jeni i bindur se nëse do të ishit ju ministër në këto momente, do të bënit këtë gjë. Nuk do ta çonit në Gjykatën Penale, por do ta çonit në Gjykatën Administrative.

Petrit Vasili – Lëre si mendoj unë për këtë punë! Mos fol në emrin tim! Unë veproj ndryshe.

Klodiana Spahiu – Unë dua që në këtë komision ne të debatojmë për të mirën e qytetarëve. Nëse ne biem dakord bashkë që të bëjmë një hap të dytë dhe hapi i dytë të jetë rritja e cilësisë, rritja e standardeve dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petrit Vasili – Le të flasë sa të dojë.

Klodiana Spahiu – Ti ke gjithë kohën që i përsërit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petrit Vasili – Fol sa të duash.

Klodiana Spahiu - Rritja e cilësisë, rritja e standardeve dhe kërkesa e tyre e vazhdueshme, jo vetëm e stomatologëve, por edhe e përfaqësive të ndryshme, që merren prej shumë kohësh me këtë punë dhe kërkojnë standarde, siç duam, edhe ne, europiane, të jetë e njëjta gjë.

Unë, edhe një herë, e para, i përshëndes dhe i falënderoj përfaqësuesit që kanë ardhur dhe mendoj të mos vazhdojmë gjatë gjithë kohës t'i trajtojmë përfaqësuesit e ministrisë sikur ata janë të pandehur dhe ne gjykatësit. Ky është një gabim shumë i madh, sepse ne duhet të qëndrojmë me të gjitha palët, megjithatë unë nuk e kam zakon as të qesh dhe as të ironizojë të tjerët. Unë jam në këtë komision për të bërë atë që është më e mira dhe kjo është rruga e duhur. Ju keni mendimin tuaj, por kjo rrugë që po ndiqni sot, duke penalizuar një njeri që thotë se ka votuar kundër, është gabim. Ju thoni se nuk është në procesverbal, por është detyrë e asaj zonjës që ta çojë në gjykatë penale atë njeri që i ka falsifikuar votën, por këtë nuk e zgjidhim dot sot këtu.

(Diskutime pa mikrofon.)

Megjithatë, të nderuara kolege, neve, si gra dhe si nëna, na takon që të jemi më të qeta dhe më me këmbë në tokë, aq më tepër kur disa prej nesh janë edhe përfaqësuese të mjekësisë, na takon që ne të jemi të vendosura për të rritur cilësinë e mësimdhënies në stomatologji, të jemi të vendosura për të rritur shërbimin stomatologjik në vendin tonë, të jemi të vendosura për të ofruar sa më mirë shërbimin stomatologjik falas deri në moshën 18 vjeç dhe ky është standardi që ne duhet të kërkojmë. Pra, ne duhet të dalim mbi forcat tona politike.

Petrit Vasili – Je ti ajo që po bën politikë këtu.

Unë kam diçka për të sqaruar. Ne sot duhet t'i qëndrojmë objektit të ditës, ndaj nëse keni dëshirë, në mbledhjen e radhës, të përcaktojmë edhe një dëgjuesë të gjatë, ku mund ta këshillojmë

ne ministrinë për mënyrën e orientimit strategjik të shërbimit stomatologjik, standardeve dhe rrugëve me të cilat mund të ecet në këtë gjë. Kjo është një çështje, që nuk është objekt i ditës së sotme, ndaj kurdo që të vijë një nismë të tillë, do të ketë votën time pro në këtë komision. Këtë mbështetje do ta jap kurdo që të bëhet kjo dëgjese, qoftë këtu, qoftë në ndonjë një qendër stomatologjie, pra ku të doni ju, ndaj këtë çështje e mbyllim këtu.

Për çështjen në fjalë kam një sqarim për të bërë për të kuptuar rrethanat. Autoriteti i Konkurrencës në vendimin e tij ka qenë shumë më korrekt dhe më i ndershëm se Ministria e Shëndetësisë. Autoriteti vëren se nga media e shkruar dhe ajo vizive jemi informuar në lidhje me vendimin e asamblesë dhe këtë e shpreh në mënyrë shumë të ndershme, ndërsa Ministria e Shëndetësisë shprehet: “Pasi u njohëm me vendimin e asamblesë...”. A mund ta di si u njoh?

Klodiana Spahiu - Me shkresë.

Petrit Vasili - Ku është shkresa?

Klodiana Spahiu – Shkresa që ka ardhur në ministri.

Petrit Vasili – Kur ka ardhur?

Klodiana Spahiu – Në datën që ka ardhur.

Petrit Vasili – Kur?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai thotë nuk ka shkresë, kurse ju thoni me shkresë! Zonja Spahiu, merruni vesh me njëritjetrit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Bardh Spahia - Më falni, dua të bëj një sqarim për ju dhe për mediet. Unë e thashë edhe pak më parë te fjala ime se votat e Ministrisë së Shëndetësisë kanë qenë dy. Kryetari i komisionit e hapi edhe një herë diskutimin, ku përfaqësuesi i Fondit ka votuar kundër, siç e di shumë mirë përfaqësuesja e ministrisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po ju them se edhe përfaqësuesi i Fondit, që është përsëri në varësi të ministrisë, ku kryetarja e bordit është pikërisht nga Ministria e Shëndetësisë, ka votuar pro vendimit të Këshillit të Urdhrit të Stomatologut. A mund të na e shpjegoni si justifikohet vota pro e dy përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë? Shumë bukur, ju zgjodhët të thoshit se është falsifikuar firma juaj ose vota juaj në procesverbal.

Antoneta Njehrrrena – Unë nuk thashë se është falsifikuar, aty ka 25 anëtarë, unë thashë se vota ime në atë mbledhje ka qenë kundër dhe vazhdoj ta ritheksoj. Urdhri e ka sqaruar që në atë procesverbal nuk e ka referuar fare votën time dhe e ka sqaruar publikisht.

Bardh Spahia – Atëherë, unë po ju them: ku janë votat kundër të përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë, sepse janë dy vota?

Mira Rakacolli – Për këtë pyesni Urdhrin? Përfaqësuesja që ka votuar thotë...

Antoneta Njehrrrena – Urdhri, nga verifikimet që ka bërë, e ka sqaruar publikisht dhe ka thënë se në atë vendim nuk e ka shprehur fare votën e ministrisë.

Bardh Spahia - Po përfaqësuesi i Fondit?

Antoneta Njehrrrena – Unë flas si përfaqësuese e ministrisë, që kam votuar kundër.

Bardh Spahia – Cila është detyra juaj në qoftë se juve ju falsifikohet firma dhe vota?

Antoneta Njehrrrena – Unë nuk po flas për falsifikim.

Bardh Spahia – Çfarë jeni ju aty? A jeni persona të marrë nga rruga, që edhe kur i vidhet vota Ministria e Shëndetësisë nuk reagoni?!

Mira Rrakacolli – Patjetër që reagojmë.

Bardh Spahia – Kur reagoni?! Pas një muaji e gjysmë, kur doli në medie? Atëherë, kur doli në medie e quani reagim ju?

Halim Kosova - A mund të bëj një ndërhyrje?

Petrit Vasili – Po.

Halim Kosova - Ne sot po debatojmë për një temë shumë të rëndësishme. Vërtet sot është marrë në shqyrtim një vendim nga Urdhri i Stomatologut, por ka disa shoqata, që nuk e ushtrojnë shërbimin e duhur karshi pacientëve dhe qytetarëve tanë.

Ne sot pothuajse të gjithë kohën e shpenzuar duke thënë reagoi apo nuk reagoi në kohë. Kjo gjë është për t'i dhënë rëndësinë e duhur, por unë do ta përmbledhja, meqenëse jam edhe afër me përfaqësuesit e ministrisë, që duhet bërë brenda afatit, por pak më vonë.

Atëherë, vazhdojmë më tej me thelbin e problemit. Pyetja ime, në mënyrë që t'i paraprijë çdolloj abuzimi karshi qytetarëve, do të ishte: a janë apo nuk janë të akredituara nga Ministria e Shëndetësisë këto klinika, që ofrojnë disa çmime të caktuara? Për fat e kam pasur në një oborr institucionin ku kam punuar me profesor Isuf Kalo, i cili ka bërë një punë të jashtëzakonshme me të gjitha materialet e duhura për 8 vjet rresht, për mënyrën se si akreditohen dhe certifikohen të gjitha shërbimet shëndetësore në vendin tonë, duke futur stomatologët, farmacistët e kështu me

radhë. Për fat të mirë, një nga përfaqësuesit më të shquar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë erdhi në vendin tonë, sërish profesor Kalon, por me ikjen e tij, ashtu si në shumë sektorë të tjerë, çdo gjë tentohet të fillohet nga zeroja. Pyetja ime është: a ka ndonjë informacion se sa klinika stomatologjike janë akredituar nga Ministria e Shëndetësisë? Sa nga këto klinika meritojnë që t'i hapin derën pacientit ose kur pacienti të trokasë të gjejë atë që duhet? Po marr një shembull personal, por e kam në formën e shakasë karshi grave. Gruaja ime është vizituar diku dhe i them: “Ku e ke gjetur këtë” dhe ajo më përgjigjet: “E kam aty afër shtëpisë”. Unë shikoj se ajo klinikë nuk ka bërë asnjë lloj certifikimi për vizitën që ka ofruar. Pra, nuk janë të pakta klinikat që nuk kanë asnjë lloj certifikimi, sepse në fushën që mbuloj unë, të ekografisë, janë pothuajse 90% e mjekëve. Kështu, i them gruas: “Për të rregulluar flokët shkon deri në malin e Dajtit për ta gjetur parukieren, kurse për të bërë një vizitë futesh te dera e parë që gjen”. Normalisht, ajo më thotë: “Çfarë faji kam unë, sepse unë kur shkoj në një klinikë e gjej mjekun me bluzë të bardhë, klinika ka një emër dhe ka një licencë të varur në mur”.

Së dyti, ajo që më bën më shumë përshtypje është kur shikoj listën nuk gjej një 7, nuk gjej një 5 apo një 2, por vetëm shifra me 0. Pra, shikoj një rrumbullakosje të frikshme, që të tregon se janë mbledhur disa vetë dhe kanë parashikuar çmimet, ku njëri mund të thotë: “Vendose 100 mijë lekë”. Pra, a ka një kosto për atë që ofrohet? Patjetër që çdo çmim i shkruar nga pas duhet të ketë një analizë kostoje, sepse nuk mund të vendoset çmimi si të teket. Për shembull, shikoj që një pacient është i shëndoshë dhe hajde t'ia fusim këtij në çmim. Absolutisht çmimet duhet të jenë të afishuara. Siç është autonomia nga njëra anë e këtyre shoqatave, se nuk është vetëm një, por janë edhe shumë të tjera me radhë, që vërtet duhet ta kenë autonominë që e kërkon ligji, e kërkon edhe koha apo që e kanë shumë vende të përparuara, ashtu edhe nga ana tjetër duhet të jetë e jashtëzakonshme mbikëqyrja nga ana e qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për këto aktivitete. Vetëm mbikëqyrja rigoroze do t'ia shtrëngojë dorën dallkaukut, që për fat nuk e kemi të vogël në vendin tonë. Në qoftë se një njeri e ndien veten të pambikëqyrur, jo në vendin tonë, por në çdo vend, sado i përparuar që të jetë, ai bën kërkinë. Vetëm frika dhe mbikëqyrja bën që ai të ecë në rrugë të mbarë.

Unë sinjerisht do t'i uroja punë të mbarë çdolloj shoqate autonome dhe të pavarur, sepse janë e ardhmja në atë sektor të caktuar si në çdo vend tjetër, por çdo fillim ka vështirësitë e tij apo ka tentativat e devijimit. Mbikëqyrja e Ministrisë së Shëndetësisë do t'i mbajë të shëndosha këto lloj shoqatash. Unë këto dy pyetja kisha dhe do të doja një përgjigje.

Petrit Vasili – Po, zonja Rakacolli.

Mira Rakacolli - Për sa i përket problemit të akreditimit, mund të them se akreditimi është në proces shumë i rëndësishëm. Ne i kemi dhënë shumë rëndësi dhe po e vazhdojmë me shumë përgjegjësi punën e nisur nga profesor Kalo, duke përcaktuar edhe standarde të reja.

Për sa i përket akreditimit, mund të them se akreditimi nuk është i detyrueshëm për një institucion, por licencimi është i detyrueshëm. Kriteret e licencimit përcaktohen qartë se çfarë kushtesh dhe standardesh duhet të përmbushë një klinikë stomatologjike për t'u quajtur e tillë. Është detyrë e Inspektoratit për të kontrolluar nëse janë plotësuar kushtet. Inspektorati i ka bërë këto kontrolle dhe ka dhënë edhe masa në ato raste ku nuk i kanë përmbushur standardet. Për sa u përket institucioneve publike në akreditim, është futur edhe Klinika Stomatologjike Universitare. Ju e dini se procesi i akreditimit është një proces i gjatë, që kërkon vetëvlerësimin e brendshëm nga personat që janë atje dhe më pas kontrollin e jashtëm, një kontroll tjetër të brendshëm e kështu me radhë. Pra, është një proces i gjatë dhe nuk është një moment.

Licencimi është një moment që vjen pas plotësimit të kriterëve. Pa dyshim, ka shumë rëndësi që të plotësohen standardet dhe kjo është në kompetencën e Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror, që të bëjë të mundur kontrollin dhe të marrë masa për ato raste kur standardet nuk plotësohen. Nga ky inspektorat është bërë një punë e mirëfilltë, por ne, si përfaqësues, nuk mund të themi se çfarë ndryshimesh të mëdha janë bërë këta 5 vjet.

Petrit Vasili – Zoti Kosova, a u shteruan përgjigjet e pyetjeve tuaja?

Halim Kosova – Po.

Petrit Vasili – Po, zonja Metaliaj.

Mira Rakacolli – Unë po flisja, por në qoftë se dikush e merr përgjigjen me një fjali, atëherë jam dakord, sepse mbledhjen e drejtoni ju.

Petrit Vasili - Unë e pyeta zotin Kosova nëse ishte i kënaqur me përgjigjet dhe ai tha “po”.
Po, zonja Metaliaj.

Lindita Metaliaj – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, unë mendoj se asnjë debat nuk është i kotë kur bëhet fjalë për të mbrojtur interesat e qytetarëve shqiptarë. Duke qenë se ne këtu jemi si përfaqësues të tyre, kemi ardhur këtu me votën e tyre, flasim në zërin dhe në emrin e tyre, ndaj përfshihemi edhe emocionalisht. Unë do të kërkoja në të njëjtën kohë që edhe përfaqësuesit e ministrisë të flasin me po kaq emocion, sepse janë në shërbim të qytetarëve dhe paguhet nga taksapaguesit shqiptarë. Në fakt, shqetësimi që kam unë

është që në ligjin “Për shërbimin stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, shërbimi shëndetësor është i ndarë në dy drejtime, domethënë ofrohet si publik, ashtu edhe privat. A ka dijeni Ministria e Shëndetësisë nëse funksionon shërbimi publik dhe a jepet ky shërbim në të gjithë Shqipërinë? Kryesisht, duke qenë se unë jam deputete e Lezhës, sipas informacionit që unë kam, nuk ka shërbim publik as në shkollë dhe as në klinikën përkatëse, që është në qendrën shëndetësore këto vitet e fundit. Meqenëse zotëria po fliste për një grup pune, që bën verifikimin e funksioneve, a janë marrë masa me gjobë nga ky grup pune? A mos ka ndonjë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit përderisa ne i paguajmë këta stomatologë publikë, të cilët nuk ua ofrojnë këtë shërbim as nxënësve në qytet, për të mos folur pastaj në njësitë administrative, që nuk bëhet fjalë fare? Cili është organi përgjegjës, pasi sipas ligjit thuhet se institucioni përgjegjës për shërbimin stomatologjik është Ministria e Shëndetësisë, sepse ajo përcakton mënyrën se si do të funksionojnë e të tjerë. Tani këto klinika ekzistojnë, por momentalisht janë të mbyllura, pasi stomatologët i ofrojnë këto shërbime në klinikat e tyre private. Por, edhe sikur të hapen, mungon infrastruktura, mungojnë të gjitha mjetet, mungojnë autoklavat, mungojnë poltronët e të tjerë. Pra, me pak fjalë në qytetin e Lezhës nuk mund të ofrohet shërbimi publik, pasi siç dihet në atë qendër shëndetësore përveç këtij shërbimi, mund të ketë edhe shumë shërbime të tjera.

Zonja Rakacolli, besoj se edhe ju e dini, është një skandal tjetër, që unë e kam denoncuar gjashtë muaj para lidhur me qendrën shëndetësore të qytetit të Lezhës, ku shërbimi shëndetësor për nënën dhe fëmijën është zhvendosur nga qendra e qytetit në periferi, rreth 2 kilometra larg. Pra, një grua shtatzënë apo një nënë me fëmijën 0 deri në 1 vjeç, në temperaturat e ulëta të dimrit dhe në temperaturat e larta të verës, u duhet të zhvendosen rreth 2 kilometra larg për të marrë shërbimin shëndetësor, që është një skandal.

(Diskutime pa mikrofon.)

Petrit Vasili – Kjo është jashtë temës së ditës, ndaj nuk keni detyrim që të përgjigjeni.

Cila është pyetja juaj, zonja Metaliaj?

Lindita Metaliaj – A funksionon grupi i punës?

Gjergji Koja - Më parë fola teknikisht lidhur me problematikën për të cilën na ka thirrur Komisioni i Shëndetësisë për sa u përket tarifave e të tjerë.

Çmimet që pretendon Urdhri i Stomatologut për t’i rritur, por që praktikisht nuk janë rritur, pa dyshim sollën një problematikë të madhe, që kishte të bënte me kostifikimin e shërbimit. Pra, nëse ne nuk kemi shërbime me kosto, atëherë nuk mund të nxjerrim asnjë lloj çmimi. Për këtë

arsye unë përmenda që Ministria e Shëndetësisë ka ngritur një grup pune, ku brenda janë të gjithë aktorët dhe faktorët. Më lejoni t'i përmend, sepse është një grup pune shumë i rëndësishëm (besoj se do ta bëjnë punën brenda orarit të punës dhe nuk do të marrin asnjë lek nga taksapaguesit shqiptarë), që përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, Urdhrit të Stomatologut, Shoqatës së Stomatologëve, Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror dhe Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave. Këta, të gjithë bashkë, në tagrin e tyre dhe sipas punëve që do të bëjnë, do të mundësojnë edhe kostofikimin e këtij shërbimi, në mënyrë që shteti, jo apriori dhe aspak në dëm të ligjeve që vepron në ekonominë e tregut, të mos i diktojë çmimet sektorit privat, por të përcaktojë çmimin dysheme, në mënyrë që ky çmim dysheme të jetë i përballueshëm nga Konispoli deri në Tropojë, deri në Durrës e tjerë. Pra, kjo është çështja e grupit që unë përmenda.

Nora Malaj - Në respektim të të gjitha dëgjësës dhe debatit, ku përtej faktit të zbatimit ligjor ka edhe një impakt social shumë të madh, do të doja të bëja një pyetje: a është ngritur një grup pune nga ministria për situatën aktuale ku jemi, për të menaxhuar të gjithë situatën para se të ndodhë procesi i vendimmarrjes ligjore, që do të thotë deri në përfundimin e aktit ligjor, që kjo është me shkelje të veprimtarisë administrative? Pra, si do të procedohet në terren, sepse ne mund të kemi subjekte të ndryshme private, që e ushtrojnë këtë profesion, por që për X arsye e marrin të mirëqenë, ndonëse ministria mund ta ketë çuar urdhrin. Por, duke pasur parasysh se ligji prevalon mbi këtë gjë dhe nuk i jep kompetencën për ta nxjerrë, si do të procedohet që qytetarët të marrin shërbimin të pandikuar në drejtim të financave? Si do të operohet lidhur me faktin e pezullimit dhe faktin e zbatimit, sepse janë të ndryshme? Populli thotë: “Nga e thëna në të bërë është një det i tërë”. Cilat do të jenë masat që do të merren, në mënyrë që ta dimë situatën rast pas rasti?

Kam një pyetje tjetër, që nuk lidhet me temën, por bëhet fjalë për situatën e fruthit. A e keni shpallur situatë rreziku kombëtar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e thashë paraprakisht që nuk ka lidhje me temën e sotme, por jua bëra këtë pyetje që të marrim një informacion më të plotë se çfarë do të bëhet?

Mira Rakacolli – Në lidhje me shqetësimin tuaj, natyrisht është i drejtë dhe është një shqetësim shumë i madh edhe i ministrisë. Autoriteti i Konkurrencës e ka pezulluar atë vendim dhe kjo është bërë publike. Njëkohësisht Autoriteti i Konkurrencës ka paracaktuar edhe masat që do të merren për subjekte, të cilat nuk do ta zbatojnë këtë vendim. Tashmë është shumë e qartë që ky vendim është nul dhe një vendim nul nuk ka shanse që të mos zbatohet në çdo shtet. Patjetër

që do të ketë kontrolle nga Inspektorati për të zbatuar ligjërisht atë vendim të Autoriteti të Konkurrencës.

Për sa i përket problemit të fruthit, Ministria e Shëndetësisë e ka pasur vazhdimisht në vëmendje me komitetet përkatëse, të cilat kanë funksionuar dhe kanë marrë vendime në përputhje me situatën. Fruthi pati një rënie shumë të madhe në fund të vitit, edhe në janar pati një rritje të vogël, sepse janë 50 raste gjithsej, krahasuar me popullsinë 2 milionë e 800 mijë. Problemi është se kjo rritje ka ndodhur te fëmijët e pavaksinuar. Pra, ky është një problem, që është i lidhur me vaksinimin, të cilin ne po e monitorojmë.

Këtë e gjë e thashë meqenëse e përmendi zonja dhe donte një përgjigje paraprake për të qenë të përgatitur, ndoshta për të qenë edhe më të përgjegjshëm në komentet që bëhen.

Unë do të thosha se nuk ka asnjë shans që urdhrat ose vendimet joligjore të përkrahen ose të zbatohen në të gjitha ato institucione që varen ose kanë të bëjnë me Ministrinë e Shëndetësisë. Kështu, ndjeshmëria kuptohet, por duhet edhe përgjegjshmëria dhe besimi, që duhet të keni të gjithë te shteti. Pra, në një shtet, që tashmë e ka demonstruar që funksionon në bazë të ligjit, nuk ka absolutisht asnjë shans që të zbatohen gjëra që janë në kundërshtim me ligjin.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime të tjera, fjalën e ka zoti Spahia dhe më pas do ta mbyllim.

Bardh Spahia – Kam edhe dy çështje, të cilat i lashë për në fund pikërisht me idenë që të ezauroheshin pyetjet kryesore që ne kishim. Unë dua të di, zonja Antoneta më rezulton që te denoncimi i Ministrisë së Shëndetësisë është kërkuar vetëm anulim vendimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra vetëm kaq.

(Diskutime pa mikrofon)

Po në raport me njerëzit që kanë marrë këtë vendim, Ministria e Shëndetësisë e gjykon të paarsyeshme që të ndërmarrë hapa ligjorë?

Antoneta Njehrrëna – Do të vazhdojë hap pas hapi. Gjykata do të thotë që ky është vendim nul dhe pastaj do të vazhdojmë sipas ligjit.

Bardh Spahia – E ka thënë ligji.

Antoneta Njehrrëna – Mbas kësaj padie do të vazhdojmë të ndjekim të gjithë hapat ligjorë ashtu siç e parashikon ligji.

Bardh Spahia – Unë mendoj që ju keni qenë shumë sipërfaqësorë në kërkesën tuaj drejtuar gjykatës. Arsyet unë i shikoj tek implikimi i Ministrisë së Shëndetësisë në atë vendim. Fajtori sigurisht që është e vështirë të akuzohet nga bashkëfajtori. Pra, informacioni është i saktë që ju keni kërkuar vetëm anulim vendimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Është shpallje e pavlefshmërisë së vendimit. Dakord. Përsëri shkon në drejtim të asaj që themi ne.

Antoneta Njehrrrena – Ky është mendimi juaj.

Bardh Spahia – Edhe një gjë tjetër. Ministria e Shëndetësisë ka rolin e mbikëqyrësit të shkëputjes së Urdhrit të Stomatologut nga Urdhri i Mjekut, që ka qenë dikur. Ligji nr.127, neni 3, kreu 10, parashikon ngritjen e asambleve rajonale. Pra, ligji e parashikon që duhet të ishin asambletë në themelin e Urdhrit të Stomatologut. Sipas rajoneve që është ndarë Republika e Shqipërisë duhet të ishin 7 asamble rajonale, të cilat sot e kësaj dite nuk rezultojnë të konstituara dhe as funksionale. Nga asambletë rajonale duhet të zgjidheshin këshillat rajonal, për të zgjedhur këshillin kombëtar dhe pastaj presidentin e urdhrit të stomatologut. A jam korrekt?

(Diskutime pa mikrofon)

Antoneta Njehrrrena – ... Ministrisë i lindte detyra që të organizonte zgjedhjet e para. Në ministri u ngrit një ekip me përfaqësues të ministrisë, nuk më kujtohen të gjithë përfaqësuesit, dhe u kryen mbledhjet për asambletë deri në kostituimin e këshillit kombëtar. Në zbatimin e të gjitha detyrimeve ligjore, që parashikon ligji nr. 127, u bënë zgjedhjet për presidentin. Pastaj urdhri organizohet dhe vepron gjithmonë vetë sipas dispozitave të ligjit. Ministria ka kryer me përpikëri të gjitha detyrimet deri në kostituimin e Urdhrit të Stomatologut.

Bardh Spahia – Nuk i ka kryer me përpikëri për sa kohë nuk janë konstituuar asambletë rajonale. Duhet të ishin asambletë rajonale që të zgjidhnin këshillat rajonal.

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo situatë është kështu siç e them unë dhe këtë gjë e di shumë mirë Antoneta. Asambletë rajonale nuk janë zgjedhur asnjëherë.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti kryetar, ky komision duhet të jetë i qartë, sepse ishte mungesa e këtyre këshillave rajonale që i jepte tagrin presidentit të Urdhrit, që sot është zënë në shkelje të ligjit dhe ka krijuar një problematikë kaq të madhe, sociale e medietike.

A jeni në dijeni të raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për veprimtarinë e Urdhrit të Stomatologjisë? Përse Ministria e Shëndetësisë ka zgjedhur të heshtë për atë raport, i cili ka gjetur shkelje të rënda dhe dëme ekonomike?

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse e doni, e kam këtu raportin, ku thuhet hapur shkeljet që janë bërë për buxhetin dhe ju ftoj ta lexoni.

(Diskutime pa mikrofon)

Po e lë me kaq, por dua të theksoj veprimet ose mosveprimet e Ministrisë së Shëndetësisë.

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Spahia!

Kisha një pyetje të fundit, sepse mbeti si fantazmë, po nga fondi i sigurimeve, kush është përfaqësues në Urdhrin e Stomatologut?

(Diskutime pa mikrofon)

Si quhet, a ka emër dhe mbiemër.

Antoneta Njehrrrena – Është një vajzë, por nuk më vjen tani emri i saj. Ne nuk bëjmë mbledhje të shpeshta dhe nuk takohemi rregullisht. Këshilli kombëtar mbledhet një herë në sa kohë.

Petrit Vasili – Dakord, nuk e mbani mend.

Unë nuk shoh se ka pyetje apo debate të tjera.

Faleminderit të ftuarve.

Mbledhja mbyllet.

Ditën e hënë do të vazhdojmë sipas axhendës.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA